

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXII i botimit, nr. 252, Tetor 2024

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro


Dukagjini, pa mësuesin, studiuesin, poetin, gazetarin e publicistin Luigj Gjergj Shyti

Me datën 24 tetor 2024, Luigj Gjergj Shytit iu dha lamtumira dhe u përcoll për në banesën e fundit, prej qindra vetëve, burra e gra, djem e vajza nga gjithë trevat e Veriut, përfshi dhe nga Peja, përfaqësues të Shoqatës "Martin Dreshaj", në mjediset e Bar- Restorantit "Orlando".

Mes tjerëve ishin të pranishme edhe N/Kryetarja e Bashkisë Shkodër, zonja Teuta Qyteza; N/Kryetari i Bashkisë së Malësisë së Madhe, zoti Sytki Ndreca dhe Konsulli i Nderit i republikës së Austrisë, zoti Gjergj Leqeja.

Fjala lamtumirës u mbajt nga Kryetari i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" dhe nga Sekretari i Shoqatës "Martin Dreshaj".

Ishin të pranishëm TV1-Channel, me gazetaren Kozeta Bruçi, dhe TV Kopliku, me të dërguarin e Gëzim Vuçaj, të cilët, përmes kanalëve të tyre, i përcollën pulikut jetën e veprën e Luigj Shytit dhe këtë ceremoni, për çka i falënderojmë!



Lamtumirë mësuesi, studiuesi, poeti, gazetari e publicisti Luigj Shyti

(FJALA NË PËRCJELLJEN PËR NË BANESËN E FUNDIT)

Për ju Gjyste, Bashkëshortja e Luigjit!
Për ju Rrezarta, Vladimiri, Genti, Nora
e Luanesha, djemtë e vajzat e Luigjit!

Për Ju Gjovalin, vëllai i Luigjit!
Për ju Marie, Gjyste, Lula, Dila e Hana,
motrat e Luigjit!

Për ju të afërmeve të Luigjit!
Për ju të pranishëm në këtë ceremoni
mortore të Luigjit!

Jemi mbledhur për të dhanë lamtumirën dhe përcjelljen për në banesën e fundit bashkëshortit, babës, vëllait, të afërmit, intelektualit, mësuesit, studiuesit, poetit, publicistit, anëtarit të formimit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", një nga drejtuesit e gazetës "Dukagjini", Luigj Shyti.

Luigji i jone, me datën 20 tetor 2024 është nda nga jeta në shtëpinë e tij, në Itali, mes dashurisë së bashkëshortes dhe fëmijëve, ashtu siç e meritonte. Ai prej disa kohe vuante nga një sëmundje e rende, e pashërueshme dhe me gjithë përkushtimin e madhe të djalit, Vladimirit dhe djalit, Gentit mjek I njohur në Itali dhe specialisteve të tjerë nuk ja doli, ndaj sot jemi prezent për ta përcjellë për në banesën e fundit..

Kush ishte Luigj Shyti?

Luigj SHYTI, ka lindur më datën 23 mars 1948, në fshatin Theth, të krahinës së Shalës, Dukagjin, i biri i Gjergjit dhe Agës,

Ishte fëmija i parë, prej shtatë fëmijësh i kësaj familje, dy djem e pesë vajza. Të gjithë janë të martuar, dhe kanë krijuar familjet e tyre.

Ishte nga një familje fshatare e thjeshtë, por, si degë pasardhëse e shtëpisë së përmendur të Lul Gjokës së Gjelajve të Thetit.

Luigji u rrit në Theth dhe punoj në Theth dhe në krahinat e fshatrat e Dukagjin deri në moshën pesëdhjetë vjeç, pastaj u vendos në Shkodër, duke vijuar punën në detyrën e drejtorit shkollë, në disa shkolla në afërsi të qytetit Shkodër.

Luigji, arsimin fillor dhe 7 vjeçar e mbaroi në Theth, me përfundime të shkëlqyera. Në vijim, për 1 vit e gjysmë, punon në vatrën e kulturës në Theth.

Ishte koha e punës vullnetare të rinisë. Luigji merr pjese në hapjen e rrugës së Malësisë së Madhe dhe tarracimin e Kodrave të Lukovës në Sarandë.

Në periudhën kur po zgjerohej shkollimi i detyruar, tashmë 8 vjeçar, u dha direktiva që të merreshin në punë, provizorisht ata nxënës, edhe të shkollës 7 vjeçare, që kishin pasur rezultate të shkëlqyera. Në këtë grup, Luigji zgjidhet i pari, në Theth, dhe fillon punë në detyrën e mësuesit në ciklin e ultë, por jo në fshatin e lindjes. Luigji ka punuar fort dhe ka pasur rezultate të mira në detyrën e mësuesit dhe në

detyrën e drejtorit shkollë kudo që ka punuar.

Luigj asnjëherë nuk e nënvleftësoi ngritjen e nivelit kulturore, mbi të gjitha ishte kusht i domosdoshëm për rritjen e aftësive metodike dhe shkencore, prandaj, sapo filloi punën regjistrohet në shkollën

pedagogjike të Shkodrës, pa shkëputje nga puna, dhe e mbaron për tre vjet, me përfundime të mira.

Luigji, në kohën kur sapo kishte filluar punën në detyrën e mësuesit, zgjidhet disa vite rresht sekretar i rinisë i krahinës së Shalës. Dëshira për të rritur nivelin ar-

simor, kulturor e shkencor, për vete, por edhe për punën që bënte në shkollë e nxit, dhe realizoi regjistrimin dhe mbarimin e Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës, sot Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" me rezultate të mira, fakultetin e shkencave të natyrës, dega biologji-kimi.

Luigji, ka punuar në Plan, Mgullë, Breglumi, Ndërlysa, Abat, Nicaj-Shalë, Theth, Mali Kolaj, Karmë, Gur të Zi, dhe në Rragam të Gurit të Zi. Këtu ka dalë në pension. Për 32 vjet nga 45 vite punë, i ka bërë në detyrën e drejtorit të shkollës.

Për punën e nderuar që ka bere, në vitin 1987 është vlerësuar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor të Shqipërisë me Urdhrin "Naim Frashri". Gjithashtu ka marrë disa certifikata dhe diploma Nderi gjatë punës, por edhe për punë jashtë shkollore. Këdo që të takosh në shkolla apo fshatra ku ka punuar, të flasin vetëm fjalë më të mira, tregojnë respekt për të.

Luigji, që në rininë e tij, nga mesi i viteve '60, është përfshirë në bashkëpunimin me shtypin lokal dhe kombëtar, me gazetën lokale "Jeta e Re", revista "Ylli", gazeta "Zëri i Rinisë", e më vonë, gazetën "Dukagjini", "Shkodra", "Shqipëria Etnike", revistat "Kumona e së Dielës", revista "Gegnia", gazeta "Korrieri", "Shekulli", "Nikaj - Merturi", me informacione, shkrime problemore, studime, e të tjera. Gjithashtu ka qenë i ftuar në emisione radiofonike e televizione lokale dhe qendrore shpesh herë, ku ka trajtuar kujdesshëm, e dhënë mendime të vlefshme për punën, zonën, qytetin, apo, për historinë, etnografinë, kulturën, turizmin, e të tjera. Ka përgatitur e publikuar, në mediat e ndryshme të shtypit, rreth 400 artikuj të kategorive të ndryshme.

Luigji, ishte pjesëtar aktiv në grupin nismëtar për formimin e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", dhe që në fillimet e saj ishte Sekretar i kësaj shoqate. Për rrjedhojë ishte nder nismëtarët e parë dhe



bashkëpunëtor për organizimin e daljen e gazetës “Dukagjini”, dhe që nga dalja e saj është pjesëtar i redaksinë e gazetës dhe prej rreth dhjetë vjetësh vijoi të ishte kryeredaktor i saj.

Luigj Shyti ishte nder aktivistet kryesorë në punën e shoqatës për realizimin e misionit të saj, mendonte dhe propozonte guximshëm për veprimtari të shoqatës, për Dukagjinin dhe më tej, duke marrë përsipër edhe vetë detyra, por edhe ndihmonte për realizimin e tyre.

Luigji ishte dhe nje bashkëpunëtorë serioz me shoqatat analoge, si me “Martin Dteshaj” në Pejë, në Tuz, në Klinë, me shoqatën “Malësia e Madhe – Nderi i Kombit”, “Xhubleta e Alpeve Shqiptare”, me “Korridorin e Alpeve” e të tjera.

Luigji vijimisht ka hulumtuar, mbledhur dhe studiuar, për historinë, kulturën, gjenezën, etnografinë, vlerat natyrore e për bimësinë. Gjithë këtë pune e ka publikuar në shtypin e kohës, por kryesisht në veprat e tij, prej 12 librave, që nga vitit 2005, si:

1. Dukagjini ka vend për të gjithë, ;
2. Gjurmë, syzime etnografike në Dukagjin,
3. Moj e mira n’ ortek të borës,
3. Lamtumirë mos thuaj, vëllim me poezi,
4. Dukagjini – rrugëtim në gjenezë,
5. Duaje emrin tënd, publicistikë,
6. Historiku i arsimit dhe kulturës në Dukagjin,
8. Dukagjini – 2012,
9. Etje, vëllim me poezi,
10. Fjalë të radha, fjalë të urta dhe shprehje popullore në Dukagjin,
11. Romanin “Blerta”,
12. "Lamtumitë miq!"

Luigji ishte aktiv me pjesëmarrjen e tij në veprimtari të ndryshme të shoqatës, por edhe jashtë saj. ishte nismëtar i Konferencës Shkencore “100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin”, mbështetur nga kryesia e shoqatës, që u zhvillua me 14 tetor 2017, në qytetin e Shkodrës; ishte nismëtar për përgatitjen dhe vendosjen e shtatores së Mehmet Shpendit në qytetin e Shkodrës.

Për punën në tërësi të këtij burri, Kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” e ka shpallur Luigjin “Nderi i Shoqatës”; në vitin 2013; me titullin “100 vjet Arsim e Kulturë në Dukagjin”, “Mirënjohja Martin Camaj”. Shoqata Atdhetare “Dukagjini” bashkë me tri shoqata të tjera në Shqipëri dhe Kosovë, kanë shpallur Gjyten e Luigjin, “Pishtarë të Arsimit”, në vitin 2018.

Luigj Shyti ishte dhe një bashkëshort i shkëlqyer, por dhe një prind shembullor. Ai u martuar me mësuese Gjyste Gilaj - Shytin nga fshati Lotajt e krahinës së Shalës. Kanë lindur dhe rritur 5 fëmijë. Të gjithë janë të martuar dhe kanë krijuar familjet e tyre. Janë të gjithë shkolluar, Njëri nga djemtë është mjek në spitalin universitar në Gjenova, Itali. Ishte gjyshi i 9 nipave dhe mbesave. Luigji e Gjystja ishin një çift shumë i pëlqyer dhe i vlerësuar nga kolegët e punës dhe nga shoqëria në tërësi.

Në punën familjare dhe realizimet shtetërore e shoqërore të Luigjit, bashkëshortja e tij, Gjystja ka qenë ndihmëse dhe mbështetje konkrete e vijueshme,



prandaj Luigji ishte ky që ishte dhe me punën e tij, me veprat e tij ka mbetur i gjallë në jetë të jetës.

Të gjithë e donim ta kishim në mes nesh Luigjin tonë, për intelektin e tij, për përkushtimin e tij, për fjalën e ëmbël dhe të qëndrueshme, për gjithçka që ka nevoje njeriu, por në mënyrë të veçantë bashkëshortja, djemtë e vajzat, vëllai e motrat, por kjo është jeta dhe duhet prituri e përballuar siç të vije.

Në emër të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” ju shprehim ngushëllimet më të sinqerta dhe qofshi me jete dhe e kujtofshi Luigjin tuaj, Luigjin tonë!

I lehtë të qoftë dheu Luigj Shyti!
I përjetshëm kujtimi i Luigj Shytit!
Lamtumirë Luigj Shyti!

NDUE SANAJ,
Shkodër, me 24 tetor 2024



Shoqata e Vëllazërisë Kosovë - Malësi e Madhe "Martin Dreshaj", në Pejë!

E nderuara Familje e Luigj Shytit!

Me dhimbje të thellë morëm lajmin për shkuarjen në amshim e më të dashurit Tuaj – Luigj Shyti, mësues studiosë, kontributdhënës në edukimin dhe kulturen dukagjinase dhe në përgjithësi shqiptare, Sekretari disa vjeçar i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" në Shkodër. Ky lajm na tronditi pa masë, sepse Luigji ishte një zë i fuqishëm dhe bashkëpunëtor i devotshëm në të gjitha takimet që janë zhvilluar për vite me radhë në kuadër të dy Shoqatave, asaj të Dukagjinit në Shkodër dhe Martin Dreshaj në Pejë. Kontributi i tij për arsimin, kulturen, publicistik si poet, në përgjithësi do të çmohet dhe respektohet nga të gjithë, sepse ai dha shembullin e njeriut në profesionin e tij për të mirën e vendit të vet. Sinqeriteti dhe përkushtimi në punë e bëjnë atë bashkëpunëtorin më të mirë të dyjave Shoqatave tona, në zhvillimin, avansimin e qytetërimit, Dukagji-

nas, Shkodran dhe në përgjithësi Shqiptar më shëmbullin më të mirë të sjelljes së tij vizionare plot edukat dhe vlerë njerzore. Luigj e kemi të vështirë të mësohemi pa ty, por ti do të mbetesh frymëzim dhe do të kujtojmë gjithmonë. Prandaj, ju lutem që në emër timin personal, të Shoqatës së vëllazërisë Kosovë Malësi e Madhe "Martin Dreshaj" në Pejë si dhe të të gjithë anëtarëve të Shoqatës sonë nga Trojet Etnike të pranoni ngushëllimet tona më të sinqerta! Past Drite shpirti i tij!

Lavdi jetës dhe vepres së Luigj Shytit!

Më Nderime të larta:
Kryetari, **Ukshin Jashari**
Sekretari, **Frasher Racaj**
Shoqata Martin Dreshaj,

Pejë, 23 tetor 2024



Luigj Shyti, një nder pishtarët e shkollimit dhe natyrëdashësit e Dukagjinit

Ka pak ditë, që mësuesi, studiosi, botuesi, njeri nder intelektualët më të spikatur që veprojnë punoi në Dukagjin dhe jo vetëm në gjysmëshekullin e fundit, Luigj Shyti u nda nga jeta. Puna dhe veprimtaria përveç në detyrën e mësuesit dhe drejtuesit shkollash u materializua në disa botime me vlerë historike e studimore, si veprimtarë shoqëror në themelimin dhe funksionimin e shoqatës dhe gazetës "Dukagjini", i cili ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm. Ai që një zë që dëgjohej për argumentin, qytetarinë në komunikim, në promovimin e Dukagjinit dhe bijave të sajë, të natyrës dhe vlerave të saj.

Unë, nuk jam nga ata që kanë jetuar dhe bashkëpunuar nga afër me Luigjin, pasi profesionet dhe vendbanimet e ndryshme disi larg nuk na mundësuan këtë. Unë në fëmijërinë time arrita të njoh mësues Luigjin në rininë e tij, mësues në fshatin Plan, në fund vitet 60- të të shekullit të kaluar. Ai ishte njëri ndër mësuesit e parë në ato vite, atëherë kur kullat tona, ndriçoheshin me pishtarë, kur prapambetja ishte tepër e madhe, por etja për shkollim dhe përparim shoqëror ishte shumë e madhe. Unë dhe bashkëkohësit e mi të sapo ulur në bankat e shkollës tek mësues Luigji nuk pamë vetëm mësimdhënësin e përkushtuar, por dhe modelin e një njeriu, që filloj të më ngulitej në mendje për edukatën, sjelljen me njerëzit, pamjen fizike dhe komunikimin me ne dhe prindit tanë.

Ne, ishim nxënësit e parë (1968 -1972) që do mbaronim ciklin 8 vjeçar në shkollën e sapo hapur në Plan. Ai jepte mësim në shkollën filllore dhe atë 8 vjeçare, nxënësit i njihje nga afër jo vetëm për formim e tyre, por dhe me hallet dhe problemet familjare, që kishim në ato vite. Me

banorët, në fshatin Plan u bë i njohur dhe i dashur, atë e lidhte dhe diçka familjare. Ishte ai fillim mbresëlënës, për mua dhe bashkëmoshatarët e mi që mësues Luigji i ri, tek sa rritej në moshë filloj të rritej dhe në profesion dhe si një njeri model nga ku mund të mësohej shumë.

Vitet ikën dhe Luigj Shyti nga një



shkollë tek një tjetër nga mësues në drejtor shkollë nëpër Dukagjin, nga një artikullshkrues pasionant në gazetën e kohës, arriti të bëhej një studiosi dhe botues skurpuloz, ai u bë njeri i nderuar dhe i respektuar në mjediset shoqërore intelektuale. Luigj Shyti dalëngadalë u bë i njohur si personalitet i arsimit dhe i letrave shqipe, që kishin në qendër Dukagjinin me njerëzit dhe natyrën e tij. Botimet e tij kanë vlerë të pamatshme për brezat që do vinë në aspektin historik dhe social.

Luigj Shytin, dua ta veçoj në këtë shkrim dhe për dashurinë për natyrën, për florën dhe faunë e saj. I lindur dhe i

rritur në mjedisin magjik të Thethit, duke njohur me vonë dhe gjithë natyrën e Dukagjinit pati kompetencën dhe realizoj shumë shkrime hulumtuese dhe reportazhe mbresëlënës. Janë shkrimet e Luigj Shytit pas viteve 90', që i dhanë Thethit atë zë të merituar për natyrën, atë largpamësi dhe çdo gjë që lidhej me turizmin, që do

një cikël me shkrime, për Florën e Parkut Kombëtar të Thethit, përshkrimin botanik, përhapjen dhe kushtet ekologjike dhe vlerat e tyre si bimë mjekësore, që u botuan në gazetën "Dukagjini" dhe "Kurora e Gjelbër", në Tiranë. Mbi ato shkrime për rreth 250-300 bimë mjekësore janë mbështetur dhe studiosi të ndryshëm të mëvonshëm, që u morën me Alpet në tërësi dhe parkun kombëtar Thethi në veçanti. Në vitet e para studiosit ishin korrekt dhe i referoheshin biologut Luigj Shytit, por me vonë për fatkeq erdhën duke e "harruar" këtë referencë.

Unë mund të shkruaja më gjatë, pasi dhe veprimtaria e Luigj Shytit është e gjatë dhe me plot arritje. Bashkëkohësit, bashkëpunëtorët e afërt studiosit dukagjinase ose jo të fushës e kanë si detyrim ti evokojnë ato vlera të botimeve dhe studimeve të realizuar nga ai në vite.

Në këtë shkrim homazh, veçova këto në dy aspekte, si një ndër mësimdhënësit e parë, si pishtar i shkollimit në Plan dhe atë të një biologut profesionist që donte, vlerësonte e promovonte natyrën me vlerat e saj.

Mësuesi, intelektual Luigj Shyti u nda fizikisht nga ne, por ai do mbetet gjatë midis nesh, në kujtesën tonë dhe si emër i përveçëm për brezat që do vinë, për ato kontribute që dha, për ato që shkroi për Dukagjinin dhe jo vetëm.

Parajsa është për ju o Luigj Shyti, pasi jetën dhe veprimtarinë tënde e ktheve në mision në shërbim dhe për të mirën e njerëzve.

Inxhinier Gjon Fierza,
25 tetor 2025

Janë të paharruara dhe me shumë vlerë

Gazeta “DUKAGJINI”, në zi për kumtuesin dhe ish redaktorin e Saj

Pas një bashkëjetese 22 vjeçare mes sfidash dhe arritjesh faqebardha, intelektual, publicisti, studiuesi dhe poeti Luigj Shyti u nda një herë përgjithmonë nga Gazeta që themeloi me koleget dhe bashkëluftëtarët, që e morën Dukagjineshën e vogël dhe ngritën në maja më larta të jetës kulturore shpirtërore të Leknisë.

Gazeta që e beri Luigjin të qaje nga gëzimi kur hodhi hapin e pare, prej kohesh qëndron vetmitarë në ish Kryeqytetin e fletoreve më të para e më të zëshme publicistikës shqiptare.

Syndritura jonë e lume sot është veshur në një vello zie më qepalla të rënduara nga lotët çurkë, që i rrodhi nder qerpikë, për humbjen e kumtuesit, reporterit, ish kryeredaktorin dhe njeriun, që e ushqeu më bujari e dhembshuri si babai bijën e vet.

Maja e Arapit njeji e mbështjellë me një shami të mugtë mjegulle. E vërejtur që herët në mëngjes qiti zënin lagje me lagje të Thethit tue;--thanë ka vdekë Luigj Shyti e hy sot në dhe moreee!- Shkolla ku more mësimet e para, mësove e drejtove disa vite, në shenjë zije uli qepenat e derës dhe dritareve.

Gjenerata të tera nxënësish, kolegesh, miq, shoke e shoqe, prindër ku punove gjithandej për 45 vjet vdekja jote i ka prekur në zemër. Jo për kortezi, por me bindje të plotë, këtu pranë arkivolit, por atje larg e larg në shtete e kontinente ku i ka çuar jeta, ngushëueshëm të kujtuan më mall e – thanë pushosh në amshim mësuasi, drejtori, kolegu dhe njeriu i mirë Luigj Shyti!

Sot Thethi humbi një vëlla të hijshëm e prezentabel si vetë bjeshka që e lindi dhe e rriti. Sot At’ Danjel Gjeçaj ka me të prite e me të bekue, për dritën e dijes që përçove ndër breza, për fidanët që ushqeve e punët e mira shoqërore që bëre. Zëri i tij elokuent ka me të thane: “Të lumtë dora që penën time nuk e le të mjerë, por e mbajte me nderë, duke çuar më tej shtigjeve të pa shkelura në punën që pata fillue unë”.

Sot Shala humbi penën më të afirmuar aktuale, njeriun me pasionin e zellshëm të studiuesit, etnografit, letrarit, fotografit, polemistit dhe aktivistit të gjithanshëm.

Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, humbi një kolonë me kapitël të mermertë.

Luigj Shyti ishte jo vetëm Sekretari për dy dekada i kësaj shoqate, tashmë historike, por një nga aktivistët më këmbëngulës në realizimin misionit të saj.

Shoqata Atdhetare “Dukagjini” u formua si një bashkësi njerëzish me vlera të thukëta atdhetare, por ajo nuk mund të rritej, të afirmohej dhe zinte kreun e vendit pa një bërthamë intelektuale, pa një grup dorëdhësish bujarë dhe pa një imunitet të fortë të mbrojtës nga politika ç’burrëues, partikulacioni i sëmurë fisnor, egoizmat dhe individualizmi i sëmurë.

Luigj Shyti do të kujtohet si bujk i mirë e aktivist i shquar social, përfaqësues dinjitoz në sa e sa tryeza të ndryshme dhe në shumë Seminare të organizuara anë

e kënde. As një herë nuk ngurroi të japë opinionin e tij, mendimin e tij, sigurisht bazuar në logjikë dhe argumente.

Luigj Shyti ishte një “mesfushorë libero” në shtegtimin e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”. Pa kulturë dhe dinjitet kjo shoqatë nuk mund të zinte vend në qytetin ku kultura është jetë. Më kulturë dhe guxim



intelektual kjo shoqatë, të cilën Luigji e kishte në krahun ka zemra shkapërceu hendeqet e fanatizmit të vjetër, paragjykimet që vinin nga si dhe armiqtë e mbjella e lënë pas nga të huaj dhe ush-



qyer nga politika që gjithkund futi hundët e beri pis, por jo as Shoqatën Atdhetare “Dukagjini”, as Luigj Shytin.

Pa editorialet, reportazhet, shkrimet historike, etnografike dhe temat më të mprehta sociale të Luigj Shytit, Gazeta e “Dukagjini” do ishte një çati, që do i mungonin shumë tjegulla. Bibliofilia dukagjinase pa botime disa vëllimshme të Luigj Shytit do kishte një grabë të pa plotësuar. Libri publicistik dhe mendimi social politik dukagjinase pa botim e “Dukagjini” ka vend për të gjithë do ishte si një ndërtesë pa dritare “Dukagjini rrugëtim në gjen-ezë” është ndoshta libri më i rëndësishëm

i jetës intensive e krijuese të autorit, për tatën tonë të vjetër historik. Si gjella pa kripë do ishin studimet etnografike të deri sotme të kësaj treve pa botimin prestigjioz “Syzime etnografike”.

Sesioni shkencorë dhe botimi voluminoz “Historiku i Arsimit dhe i Kulturës në Dukagjin”, që ka brenda, idenë, projektin,

nas” disa kanë ilustruar faqet e gazetës “Dukagjini” dhe rrjetet sociale.

Vdekja i gjeti pretext dhe e shytoi, kur dukej si lis i shëndetshëm. Luigji kishte ende projekte në fushën studimore, publicistikë, në prozë e të tjera.

Luigj Shytin e kam njohur vetëm vizualisht, përpara se të na bashkonte Shoqata Atdhetare “Dukagjini”. Aty lindi një miqësi e pa shlyer, pa kurrfarë interesi vetëm mbi baza të idealizmit dhe vullnetarizmit idealist.

Kryesia e shoqatës sonë shpesh është shigjetar politikisht, krahinarisht dhe mbi të gjitha zhelozisht, por as një here nuk u gjet një çarë mes nesh. Edhe kemi debatuar, por kurrë nuk pati ngritje imponuese zëri. Kurrë nuk pati ulu ti se nuk di gjë. Këtu behet si të them unë! Kurrë nuk i tha kush shoqit po rre, as nuk u ndamë pa fol me njeri tjetrin.

Luigj Shyti ishte pike fortë e kësaj harmonie shumë civile. Ai ishte një dëgjues i durueshëm, me çdo kategori dhe çdo moshë, por edhe debatues me pjekuri e maturi të rrallë.

Luigj Shyti ishte promovues shembullorë i kujtose historike kulturore të Dukagjinit. Qe shumë aktiv në punën për ndërtimin e busteve të fatosit të lirisë Mehmet Shendi e Albanologut Martin Camaj, iku më një zhgënjim nga vonesa e sterzgjatur për vendosjen e bustit të realizuar të Lekë Dukagjinit.

Luigj Shyti foli me zë të lartë e shkroi qindra e qindra faqe për Dukagjinin.

Ai po ikën sot i heshtur dhe vlerësuar nga opinioni i gjerë publik. Ndërsa institucionalisht, as Komuna Shalë, as nga as një Njësi Administrative e Dukagjinit, as nga Bashkia, as Këshilli i Qarkut nuk u fol as nuk mori as një vlerësim sa ishte gjallë!

Luigj Shyti e përmbushi më së miri detyrën ndaj familjes, miqve, shokëve, bashkësisë ku jetoi, Shkodrës e Veriut të Shqipërisë!

Luigj Shyti në fushën e shkollimit, kulturës, studimit dhe krijimtarisë ka bërë më shumë, nëntëdhjetë përqind se, të atij eposi, që sot këndohen vend e pa vend, për komercial dhe duartrokitjeje, në mënyrë butaforike, duke merre miliona klikime nën efektin alkoolit dhe pa diturisë.

I sugjeroi Kryesisë së Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” që t’i propozoi Këshillit Bashkisë dhe të ndiqet me përparësi vlerësimi i merituar dhe i vonuar që meriton të marrë Luigj Shyti, tashmë pas vdekjes.

Pushofsh në paqe miku shoku dhe bashkëpunëtori im dhe i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, i gazetës sonë “Dukagjini”, Luigj Shyti!

Ngushëllime familjarëve!

Familja, Thethi, Shala, Dukagjini dhe Shkodra duhet të jenë mirënjohës!

Pushofsh në amshim!

Nga Prelë Milani

Shqipëria Veriore në vitet 1879 - 1918 dhe impakti i fuqive Evropiane

Konsullata e Nderit e republikës e Austrisë në Shkodër, në kuadrin e 20 vjetorit të vendosjes në Shkodër të Konsullatës së Nderit të republikës së Austrisë, në bashkëpunim me Universitetin "Luigj Gurakuqi", me datën 18 tetor 2024, organizoi e zhvilloi Konferencën shkencore ndërkombëtare, me temën "Transformime dhe ndikime, Shqipëria Veriore- 1879 - 1918 dhe impakti i fuqive Evropiane", e cila u zhvillua në mjediset e Universitetit "Luigj Gurakuqi".

E veçanta në këtë konferencë ishte, se lektoret ishin nga Shqipëria (Tirana e Shkodra), nga Turqia, nga Mali i Zi dhe nga Kodova.

Në këtë konferencë merrni pjesë shumë personalitete të qytetit të Shkodrës, studentë e përfaqësues të shoqërisë civile.

Konferenca u hap nga Konsulli i Nderit i Austrisë në Shkodër, z. Gjergj Leqeja, përshëndeti Rektori i Universitet, Profesor Doktor Tonin Gjuraj dhe pastaj referuan:

Prof. as. Dr. Hasan Bello (Shqipëri - Tirana), me temën: "Austro-Hungaria dhe Kulstusprotektorati austro-hungarez mbi katoliket shqiptare (shekullin XVIII - fillimi I shekullit XX)";

Prof. Dr. Vahdettin Engin (Turqi), me temën: "Një këndvështrim i përgjithshëm i Abdyl Hamitit II ndaj politikës së Shqipërisë";

Dr. Adnan Prekic (Mali i Zi), me temën: "Shqipëria në lindje të Adriatikut, në projektimet e politikës së jashtme francezë, në gjysmën e dytë të shekullit XIX";

Prof. as. Dr. ILir Rruga, (Turqi), me temën: "Struktura fetare e popullsisë dhe e ndërtesave fetare sipas vjetarit (salnames të vitit 1892) të krahinës së Shkodrës";

Prof. as. Dr. Syle Ukshini (Kosovë), me temën: "Qëndrimi i diplomacisë gjermane ndaj çështjes shqiptare, në Konferencën e Londrës";

Prof. Dr. Romeo Gurakuqi (Shqipëri - Shkodra), me temën: "Italia dhe Austro-Hungaria, qëndrimi ndaj Shqipërisë, shtator 1914 - maj 1915";

Dr. Dom Nike Ukgjini (Kosovë - Shkodër), me temën: "Fenomeni i pagëzimit dhe ripagëzimit të dhunshëm të shqiptareve nga serbet e malazezet me 1913, si pasoje e pushtimit";

Prof. Dr. Nertila Haxhia Ljarja / Gjovalin Çuni - studiues (Shqipëri - Shkodra), me temën "Një vështrim mbi ditarët e kujtimet e shqiptareve dhe të huajve mbi Luftën e Shkodrës tetor 1912 - prill 1913";

Vukan Raznatovic / Filip Kuzman, studiues (Mali I Zi), me temën: "Shkodra në projektet e politikës së jashtme të Malit të Zi, në fillim të shekullit XX - Studim rasti: Inventari pasuror shtetëror, 1915";

Dr. Ugur Sezer (Turqi), me temën: "Veprimtaritë e konsujve austro-hungareze në Shqipërinë e Veriut sipas burimeve historike turke (1873 - 1913)";

Prof. as. Dr. Eranda Halluni / Dr. Bendis Kraja (Shqipëri - Shkodra), me temën:

"Roli i Austro - Hungarisë në përkrahjen dhe zhvillimin e arsimit në Shqipëri (1916 - 1918) sipas dokumenteve arkivore të Perandorisë".

Konferenca u zhvillua me dy seanca dhe ne mes tyre pati një koktej

Fjala e hapjes së Konferencës e Konsullit të Nderit të Republikës së Austrisë, në Shkodër, z. Gjergj Leqeja:



Të nderuar pjesëmarrës!
Miq e të ftuar!

Ballkani pjesë e së cilës është Shqipëria, historikisht ka qene shesh i konflikteve, pretendimeve e ndikimit të "Fuqive të mëdha", duke filluar nga ajo Romake e deri te fuqitë e vona e të sotme Evropiane dhe më gjerë. E si rezultat i këtyre kjo zone vazhdon të jete në një "situate potenciale konfliktuale", ku here mbas here dalin në pah problematikat nder-etnike, religjioze a territoriale, që për mendimin tonë ndikojnë në cenimin e stabilitetit dhe paqes ndërmjet vendeve e popujve tonë, të cilat janë aq të nevojshme e të kërkuara nga shumica absolute e popujve e institucioneve të politikës së vendeve

Evropiane e botërore.

Sigurisht, historia e ekzistencës këtij rajoni dhe marrëdhëniet mes popujve dhe shteteve janë trajtuar në shumë dokumente historike nga autorë dhe institucione të ndryshme akademike e shkencore, por megjithatë, ne besojmë se ende ekzistojnë dokumente të pa eksploruara ose të pa publikuara, të cilat kërkojnë interpretime më të plota dhe, ndoshta, këndvështrime të reja.

Pikërisht për këtë, në kuadër të vep-

luftërat ballkanike, Shqipëria Veriore ishte një pikë kyçe e interesave ndërkombëtare. Ndryshimet e kësaj epoke na tregojnë se sa e ndërlikur ishte historia jonë me dinamikat e fuqive të mëdha dhe strategjitë e tyre. Pikërisht këto aspekte duam të theksojmë sot, duke ofruar një platformë për studime të reja dhe këndvështrime të ndryshme që mund të na ndihmojnë të kuptojmë më mirë periudhën 1878-1918.

Qëllimi i kësaj konference nuk është absolutisht tendenca e rishikimit të historisë e përdorimi I shembujve te se kaluarës për të krijuar e nxite polemika jo konstruktive, karakteristike për Ballkanin, por përkundrazi me qëllimin e mirë për të evidentuar e ndriçuar fakte historike të tilla, që me të "përbashkëtat" të ecim përpara në rrugën pa kthim të integritetit në familjen e madhe Evropiane...

Me këtë rast dëshiroj të falënderoj përzemërsisht Universitetin "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës dhe personalisht Rektori Prof... Dr. Tonin Gjuraj, për bashkëpunimin e sidomos miqtë e mi bashkëpunëtorë Dom Nike Ukgjini e Prof. Dr. Nertila Ljarja, për idenë e punën e pakursyer për realizimin e kësaj Konference

Dua të falënderoj nga zemra të gjithë studiuesit që kanë sjellë punimet e tyre dhe që do të ndajnë gjetjet e tyre sot. Punimet tuaja nuk janë vetëm një kontribut i çmuar për historinë shqiptare, por edhe një burim frymëzimi, për ata që do të vijon të eksplorojnë dhe të shkruajnë për këtë temë.

Dhe se fundi, por jo nga rëndësia një falënderim për të gjithë ju që gjetet kohen për të qene të pranishëm në këtë konferencë shkencore të cilës i uroj sukses...

Faleminderit....

Redaksia



Fjala përshëndetëse e Konsullit të Nderit të republikës së Austrisë në, Shkodër, z. Gjergj Leqeja

Të nderuar përfaqësues të bashkësive fetare!
Të nderuar drejtues të pushtetit vendor!
Të nderuar deputete të Kuvendit të Shqipërisë!
E nderuar Shkëlqesi Ambasadore e Republikës së Austrisë Zonja Zach!
Të nderuar miq!

U bene 20 vite, qe fale jush, qe gjithmonë gjeni kohen me na u bashkua, festojmë Ditën Kombëtare të Austrisë mike, dhe për këtë nuk gjej fjale si me ju falënderua....

Faleminderit!

Festojmë sonte mbas veprimtarisë shumë dinjitoz, Konferencës Ndërkombëtare, me temën "Transformime dhe ndikime në Shqipërinë Veriore 1878-1918" të zhvilluar në bashkëpunim të shkëlqyer me Universitetin "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës, që ndoshta për here të pare u mblodhën studiues nga Shqipëria, Turqia, Mali i Zi e Kosova, për të paraqite studime mbi fakte historike ndoshta të pabotuara deri tash, e që për mendimin tonë kane nevojë për komente ndryshe apo rishikime, që lidhen me historinë e Shqipërisë, në prag e mbas shpalljes së Pavarësisë.

U pasqyrua në shumë referate të kësaj Konference, Austro - Hungaria e asaj kohe e Austria e sotme janë prezent në Veriun e Shqipërisë, me qendër në Shkodër, që në fillimet e shekullit të XVII, dhe unë jam krenar, që të përfaqësoj një komb me kaq shume dimensione kulture, zhvillimi e humanizmi dhe jam po aq krenar, që lidhjet mes

102 vjetori i marrëdhënieve diplomatike Austri-Shqipëri

Konsulli i Nderit të republikës së Austrisë, në Shkodër, Gjergj Leqeja, me datën 24 tetor 2024, organizoi në mjediset e Hotel "Rozafa", në Shkodër, festën e Pavarësisë së Austrisë, në të cilën mori pjese edhe Ambasadorja, Monika Zch, e cila deklaroi se Austria historikisht ka qene në përkrahje të Shqipërisë, dhe kështu do të vijoi e vendosur edhe në rrugën e integritimit Evropian.

Për të 20-tin vit radhazi, Dita Kombëtare e Austrisë festohet në Shkodër, e organizuar nga Konsulli i Nderit i Austrisë, Gjergj Leqeja.

Prania e Hierarkisë Kishtare, deputetëve, drejtuesve të pushtetit vendor dhe të prishmeve, paraqet punën e mirë, që për 20 vite ka shpalos në të gjitha komponentët e saj, Konsulli i Nderit z. Gjergj Leqeja.



kombeve tona po forcohen dita ditës.

Austro - Hungaria dhe Austria e sotme janë miqtë më të sinqerte e të vlefshëm historike të kombit e popullit shqiptar, që jo rastësisht kane pas rol shumë të rëndësishëm e shpesh here vendimtar, në vendimet e veprimet ku është vendose fati politiko-historik i kombit e shtetit tonë. Edhe në ditët e sotme Austria, me drejtuesit e saj kanë qene e vijnë të jene përkrahës e garantë në rrugën pa kthim të Shqipërisë, në familjen Evropiane. Mjafton të kujtojmë qëndrimin e Ministrit të Jashtëm Hungarez të ditëve të fundit presa i përket domosdoshmërisë së fillimit të negociatave për anëtarësim të Shqipërisë, në BE dhe kjo nuk është vetëm rastësi.

Austria është prezentë edhe në jetën ekonomikokulturore të vendit dhe sidomos në Veriun e Shqipërisë, duke filluar në atë të shkollimit, me Shkollën "Peter Mahringer" si një nga shkollat më të mira profesionale të vendit, Institucionet financiare si "Raiffeisen Bank", "Uniqa Group", "Vienna Insurance Group", në Sektorin energjetik me Hidrocentralin e Ashtës, projekte të furnizimit me ujë të pashëm, bashkëpunimin shumë të ngushtë e të frytshëm të universiteteve Austriake me Universitetin "Luigj Gurakuqi", në Shkodër e të tjera dhe jam i bindur, që këto marrëdhënie të shumanshme vijnë çdo ditë duke u forcua padyshim dhe me ardhjen e Ambasadores së re të Republikës së Austrisë, në Shqipëri .Shkëlqesisë së Zj. Monica Zach, të cilës edhe në emrin tuaj i urojmë sukses në punën e saj, në të mirë të të dy vendeve tona.

Edhe një here shumë faleminderit për prezencën dhe gëzuar Festën Kombëtare të Austrisë!

Faleminderit!

Roza Pjetri

Familja, traditë e mrekullueshme dhe e ardhme e sigurve

Këshilli Rajonal i Paqes Shkodër organizoi, më 9 tetor 2024, në ambientet e Teatrit "Migjeni", veprimtarinë me temë "Familja, Traditë e Mrekullueshme dhe e Ardhme e Sigurve".

Rreth 100 Ambasadorë për Paqe, miq të Federatës së Paqes, të ftuar të veçantë dhe të rinj zbkuruan me prezencën e tyre sallën e teatrit.

Veprimtaria u drejtua nga znj. Majlinda Laçaj, kryetare e Këshillit Rajonal të Paqes Shkodër, e cila në fjalën e saj të mirëseardhjes theksoi nevojën që institucioni i familjes të jetë në fokus të të gjithëve. Familja është baza ku ndodhin marrëdhëniet ndërpersonale, edukimi dhe transmetimi i traditave, vlerave kulturore e morale, ajo ndihmon në formimin e identitetit individual dhe kolektiv të shoqërisë sonë. Kjo traditë është bashkudhëtare e pandarë e njerëzimit prej mijëra vitesh edhe pse bota është përbalhur me ndryshime dhe periudha historike, të cilat kanë lënë gjurmët e tyre në shoqërinë tonë, thelbi i familjes ka mbetur po ai dhe rëndësia e saj po ashtu, unike, e papërsëritshme, e pazëvendësueshme, e patjetërsueshme.

Në botën moderne, ku shumë aspekte

të jetës po ndryshojnë me shpejtësi, roli i familjes mbetet kritik për sigurimin e një ardhmërie të qëndrueshme. Ruajtja e traditave familjare, vlerave njerëzore dhe përvetësimi i vlerave universale, forcon lidhjet brenda familjeve, por gjithashtu kontribuon në stabilitetin social gjerësisht dhe kështu në krijimë bazat për një shoqëri më harmonike dhe koherente, krijimë bazat e një trashëgimie të forte, të ardhme të qëndrueshme dhe të sigurve për brezat që vijnë.

Veprimtarinë e përshëndetën edhe



Kwon Inson, zv. Presidenti Federatës për Evropën dhe Lindjen e Mesme

z. Kwon Inson, zv. President i Federatës për Evropën dhe Lindjen e Mesme; z. Ali Laçej, koordinatori i Këshillit Shqiptar të Paqes; znj. Manjola Vasmatics, Presidente e Federatës së Familjes në Shqipëri, dhe znj. Marie Koliqi, nënkryetare e Këshillit të Paqes në Shkodër.

Falë bashkëpunimit mes Federatës së Paqes Universale dhe Bashkisë Shkodër, Qendra Kulturore e fëmijëve "Kujtim Alija" Shkodër, mbështeti veprimtarinë përmes performancave të fëmijëve të saj të talentuar, duke përcjellë tek pjesëmar-



rësit emocione të mrekullueshme. Qëllimi i veprimtarisë ishte gjithashtu nderimi i disa figurave me kontribute të veçanta në komunitetin shkodran, por jo vetëm, me titullin "Ambasador për Paqe". Mes tyre mund të përmendim rektorin e Universitetit Shkodër Prof. Dr. Tonin Gjuraj; artistët e mëdhenj të Shkodrës dhe Shqipërisë z. Besnik Çinari dhe znj. Drande Xhaj; aktorin e mirënjohur dhe drejtorin e teatrit "Migjeni" z. Arjan Çuliqi; shkrimtarin e njohur ndërkombëtarisht z. Mark Zadeja; studiuesen dhe ish të përndjekurën politike znj. Fatbardha Saraçi; inxhinieren e shkrimtaren e mirënjohur znj. Zenepe Dibra; mësuesin pasionant z. Besim Zagani, dhe mjaft figura të tjera të nderuara nga fusha të ndryshme, ku ata operojnë profesionalisht si: drejtues institucionesh, biznes, mjekësi, vullnetarizëm e të tjerë.

Një familje dhe shoqëri ideale, karakterizohen nga vlera morale, etike, mirësie e drejtësie dhe të gjitha këto bashkë, përbëjnë vlerat universale për një botë që jeton në paqe.

Majlinda Laçaj



Festë poetike në Malësi të Madhe

Në sallën e konferencave të “Deluxe Resort” u bë promovimi i dy librave me poezi të autores Malësore znj. Vera Gjonaj.

Pata privilegjin, por edhe përgjegjësinë që ta drejtoj këtë veprimtari të mrekullueshëm dhe të veçantë për nga cilësia dhe niveli.

Organizuar nga Shoqata e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Veriut, në bashkëpunim me mbështetje të grupit dhe Kryetarit të Bashkisë Malësia e Madhe, z. Tonin Marinaj.

Një sallë moderne mbushur me intelektual, poet, shkrimtarë dhe artiste të zgjedhur.

Dua të falënderoj znj. Vera Gjonaj dhe dy djemtë e saj, për mikpritjen dhe ambientin miqësor artistik që na krijuan.

Jeta e secilit nga ne matet me çastet dhe ditët që përjetojmë, jam i bindur se këtë dite do ta kujtoni gjatë në sensin artistik, kulturor, miqësor dhe argëtues.

Jam ndier vërtet mirë dhe i privilegjuar mes jush miqtë e mi të nderuar. Me ju rritet frymëzimi, faleminderit për fjalën dhe kontributin tuaj z. Tonin Marinaj, z. Can Tahiri, z. Ilmi Kurti, znj, Prenda Sejdia, z. Vlash Linadi, z. Prele Milani, z. Kadri Ujka, z. Gjovalin Veshtaj, znj. Besarta Shkoza, z. Mark Luli, znj. Bukurie Maloku dhe shumë të tjerë.

Një Mirënjohje të veçantë për poetin, Mimoza Hoxha Agastra, me të cilën e bashkëdrejtuaam këtë veprimtari.

Kam shumë fjalë të bukura dhe falënderuese për të thënë, por do të postoj fjalën time, për të dy librat e znj. Vera Gjonaj.

“Librat tuaj në syrin tim”

(Recension letrar)

Përmbledhja më poezi që ka për autore vajzën Kuksiane, nusen Malësore dhe intelektualen emigrante znj. Vera Gjonaj nga sot është në dorën e lexuesit.

Ky është libri i saj i parë, në të cilin ka përfshirë poezi të shkruara ndër vite, të ruajtura në shpirt dhe fletore për t'i sjellë sot para jush, por me maturi e pjekuri poetike.

Gjithmonë kam besuar se, në shpirtin e secilit nga ne ka një engjëll poetik.

Shpirti poetik i secilit nga ne bashkëjton me virtytet dhe dhuntitë tona, pastaj se kush lulëzon në jetë kjo varet nga rruga e jetës sonë.

Askush, kur shkruan, kur flet apo argumenton nuk e fsheh dot botën e tij të brendshme. Poezia është muzika e shpirtit, prandaj çdo poezi është e bukur sikurse çdo lule është e bukur në pranverë.

Në flatrat e librit të saj, autorja na duket si një lule që shpërthen pas një pranvere të vonuar.

Si erdhi midis nesh poetja e re Vera Gjonaj? Mendoj se asgjë nuk ndodh rastësisht në këtë botë, talenti që të ka dhënë Zoti, një ditë do të gjej rrugën e vet për të shpërthyer.

Autorja vjen si vala e Drinit, që ka të ngulitur në memorie Kukësin e Vjetër, ka në sy flladin e Gjallcës dhe në shpirt lule - zambakët e Hasit dhe vargjet i ka mbledhur në livadhet e Pashtrikut. E gjithë ajo botë poetike, me të cilën u rrit Vera në rininë e saj mbeti e arkivuar në ëndrrat e

saj. Them, në ëndrrat e saj, sepse një tjetër ëndërr e mori si engjëll mbi krahë për ta sjellë në Malësi të Madhe. Vera Gjonaj do të bëhej nusja e Reçit, do të diplomohet në Fakultetin Ekonomik dhe do të bëhej nëna e dy djemve.



Në këto rrethana, dhe në ato vite (jemi në kapërcyell të shekullit të ri) askush nuk do kishte kohë as luksin për një libër me poezi.

Nëse do të më duhet të perifrazoj se, si ishte ajo kohë mundem të them shkurt se, bilbilat braktisën bjeshkën dhe dallëndyshet braktisën fushën.

Në pranverën e vitit 2001 edhe zonja Vera së bashku me familjen do të zhvendosej si mërgimtare në Milano, Itali.

Vetë jeta është një poezi dhe poezia e jetës së saj shkruhet çdo ditë diku në auditorët e shpirtit. Unë nuk do ta kisha njohur asnjëherë dhe poezia e saj do te vijonte gjumin letargjik nëse Grupimi Ambasador të Paqes, dega për Shqipërinë nuk do ta ftonte znj Vera në gjirin e kësaj Organizate Humanitare. Për kontributin e saj në mbështetje të emigrantëve Shqiptarë dhe shtresave në nevojë në Itali dhe Shqipëri.

Aty në atë ambient me koleg artiste, poet dhe shkrimtarë duket se nisi të çel gonxhet e fjetura trëndafili i saj poetik.

Duke pasur mbështetje të vijueshme nga koleg dhe miq të saj ajo vjen sot me librin e parë me poezi “NË FLATRAT E MALLIT”

Si e shoh unë nivelin artistik, tematikën, mesazhin poetik dhe pse duhet ta lexojmë këtë libër, do të përpiqem ta them sipas këndvështrimit tim.

Së pari, Vera në librin e saj, flet me gjuhën e dashurisë në të gjitha trajtat e saj. Herë na shfaqet e dashuruar në pafundësi, e herë e zhgënjyer në ekstrem. Shpesh na paraqitet si një manushaqe ndër ferra dhe dy-tri poezi më vonë si një vetëtimë e dashuruar, që djeg çfarëdo që i del përpara, derisa të arrijë te princi i saj i kaltër. Poezitë e saj janë të thjeshta, për tu lexuar,

por çdo varg përcjell mesazh. Vargu i saj bëhet interesant kur e lejon dhe e detyron lexuesin të imagjinojë dhe ta kërkojë vetveten në poezinë e saj.

Duket sikur poezia e saj është në mënyrën dëftore sikur janë përjetime personale, por në shumicën e tyre lexuesi gjen një pjesë nga vetvetja.

Autorja përshkruan brezin e saj deri në adoleshencë, atë brez, ata të rinj që përjetuan dy tre sisteme jetese sociale dhe sot në pjekurinë e tyre janë si një thesare poetik me vlera.

Jam i bindur se në sirtarët e saj ka të tjera poezi më të fuqishme, sepse ajo ka një prirje të shkojë edhe më larg.

Mendoj se, autorja nuk lodhet shumë se çfarë do të thotë kritika letrare mjaftohet të hedhë mbi letër botën e saj të brendshme. Shkruan vargun e lire, duke përdorur rimën aty ku nuk ja cenon mendimin.

Vera është një ekonomiste me profesion, një juriste me punë dhe një poete me shpirt, në vargjet e saj shoh ndjenjë, dashuri dhe përcjell mesazh. Duke lexuar poezitë e këtij libri, unë lexoj hapur nivelin intelektual dhe formimin njerëzor, forca e vargut shpreh thellësinë e mendimit.

Le të citojmë disa vargje nga poezia:

“Aspak rehati nuk gjejmë

Këtu në vendin e shqiponjave

Me strajcën mbi supe

Vrapuam...

Vrapuam t' kërkojmë shpresën”

“KJO KOHË SHTERPË”

Titull metafizik pastaj edhe në vargje, brenga e një mërgimtare dhe sakrificë e tij.

Sa e sa janë bijtë e Shqipës, që duke kërkuar shpresën e lanë rininë rrugëve të botës. Sa me shumë që kalojnë vitet aq më e rëndë bëhet strajca e mërgimtarit. Duke lexuar këtë libër mendoj se çdo lexues ka kaluar një terapi, ka gdhendur diçka të re në ndërgjegje dhe në botëkuptimin e tij. Nëse mjeku është shërues i defekteve mekanike të trupit njerëzor, artistët në përgjegjësi dhe poetet ne veçanti janë mjek të shpirtit njerëzor. Mendoj se poezia duhet të jetë së pari mesazh për lexuesit dhe vargjet e këtij libri kanë shumë mesazhe brenda.

Askush nga ne që shkruajmë nuk na ndodh të marrim lapsin të ulemi mbi tavolinë dhe pastaj të kërkojmë një subjekt apo një temë për poezi.

Vargu poezia janë ndjenjë, janë pjesë e shqisave tona, që vetëm ne digjmë ti gjejmë shtigjeve të universit jetësorë. Kjo më bën të mendoj se, këto poezi kanë bashkëjetuar, janë rritur bashkë me Verën nder vite. Le të citojmë diçka nga poezia “KËNDOJ PËR TY”:

“Shpirti i poezisë krahas me hyjni

Herë ziliqare herë melankoli

Për ndjenjat e valëzuara

ngremë nga një doli ...!”

Kur i hapa në kompjuter këto poezi menjëherë më shkoi mendja ti ul në tavolinë si të ishin gurë shahu! Nuk e kisha aspak të vështirë, që të dalloj figurat kryesore, sepse autorja shkruan me gjithë shpirt për prindërit e saj. Me nostalgji, re-

spekt e dhimbje dhe vlerësim na sjell atë stil vargësh, që zakonisht çdo poet i ka në librin e parë. Askush nuk do të donte që dashurinë e parë ta kalonte nëpër gojë të botës, askush nuk do të donte që librin e parë t'ia gozhdonte me shigjeta kritike. Mendoj se për znj. Vera ky libër është një frymëzim i brendshëm, pastaj një dhuratë për veten dhe familjen e saj.

Kam parë aty disa poezi për fëmijët, mbesën, bashkëshortin, që nuk po citoj asnjëherë nga ato, por më kanë bërë përshpirtje epitetet e përdorura.

dritë ylberet e mi, faqemolla e gjyshes, shpirt-profli i bukur.

“Në bllokun e shpirtit ca mendime hodha

si fillim hodha vargje ato të dashurisë

tjera që më ngelën

sërisht sistemova

për hir të pushimeve e shpirtit të lirisë”

“SHPIRTI I LIRISË”

Dashuria është bakllavë e çdo poeti, nuk kishte si të mungonte në këtë libër të shkruar nga një zonjë që siç duket i ka humb çelësi i viteve. Lulet, liqeni, deti, fluturat, ylberi, por edhe loti melankolik janë subjekt dhe objekt në lirikën e librit, por kur është fjala për dashurinë tregohet shumë e rreptë.

Në këtë libër ka një kolor ngjyrash dhe tematike, Kosova dhe Reçi, Malësia dhe Kukësi, Milano dhe Velipoja prandaj është një relike në bibliotekën tonë, është një emocion, që autorja e ka ruajt gati me fanatizëm deri sot.

Populli thotë se çdo nuse shkëlqen në ditën e dasmës, prandaj unë nuk kërkoj kurrë ku ka pikuar çatia në faqet e një libri, për mua çdo poezi është një meteor.

Le të zërthejmë vetëm dy vargje nga poezia:

“Të thurë për ty vargje si kurorë

Të bashkuara vullkani me meteorë,,

‘DOJA CA METEORË’

Me plot bindje mundem të them se ky libër është vullkan i shpirtit të saj, një vullkan që ka peshkuar meteorë në qiellin e ëndrrave.

Urime artiste!

Mirë se erdhët në familjen e miqve të librit, shpirti juaj paqësor dhe poetik është një pasuri që kur e kthen në poezi dhe bamirësi, vlen shumë për shoqërinë.

“Durimit nuk i bëhet jehonë

Ai është si një nuse në duvak”

Me këto vargje. që gjenden në një poezi të këtij vëllimi do e mbyll këtë pasthënie: Mendoj se durimi është babai i suksesit dhe guximi nëna e tij! Ju guxuat dhe i'a keni arritur të jeni një grua e suksesshme. Ju keni duruar me vite frymëzimin tuaj poetik, për ta sjellë sot në të parim libër me poezi. Nga flatrat e mallit uroj që të hapen horizonte të reja për ju.

Le te jete ky opinionin i imi një kafe relaksi para se të lexojnë poezitë tuaja!

Suksese!

Lulash Brigja

Shkodër - tetor 2024

Lamtumire Pjeter Geraj, rapsodi i veçantë

Për ju Genci e Tushi, djemtë e Pjetrit!
Për ju Rita, vajza e Pjetrit!
Për ju Kola e Gjoni, vëllezërit e Pjetrit!
Për ju Mrika, motra e Pjetrit!

Për ju të pranishëm në këtë ceremoni mortore të Pjetrit!

Jemi mbledhur për të dhanë lamtumirën dhe përcjelljen për në banesën e fundit të babës, të vëllait, të afërmit, studiuesit, poetit e publicistit, anëtarit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Pjeter Geren.

Pjetri i jonë, me datën 27 tetor 2024, pas nje aksidentit të momentit dhe me gjithë përpjekjet e personelit shëndetësor, u nda nga jeta, ndaj sot jemi prezent për ta përcjell për në banesën e fundit.

Kush ishte Pjeter Gera?

Pjeter Mark Rrustemi - GERAJ ka lindur në fshatin Toplane, me 2 shkurt 1934, i biri i Markut dhe i Prendës, në një familje me tradita të njohura në zonën e Dukagjinit.

Pjetri pati vështirësi në moshën e rritjes, se pa mbush moshën 1 vjeç mbeti jetim, se baba i tij, Marku u nda nga jeta; ndërsa nëna shkoj në gjini, sipas traditave të kohës. Pra, Pjetri u rrit nga axhët Gjini, Ndoka e Pali, të cilët me familjet e tyre i kane treguar një përkujdesje të veçantë. Përkujdesja e tyre e shkëlqyer, mësimet e tyre i prinë në gjithë jetën e tij.

Shkollën fillore e kreu në fshatin Toplanë, ndërsa atë 7 vjeçare e të mesme të përgjithshme, i beri në qytetin e Shkodrës.

Me 10 nëntor 1953 deri me 11 nëntor 1956 mobilizohet ushtar 2 vjeçar, në Korçë, në detyrën e korrierit te batalionit.

Në vitin 1954, në ushtri është pranuar anëtar i PPSH dhe ka qene anëtar i saj deri

në vitin 1974, i cili në këtë vit është përjashtuar nga radhët e saj, për mos deklarimin e dajave, Gjoke Vocri e Mark Ndue Prendi, me qëndrim jo të mirë politik.



Nuk është angazhua në asnjë parti tjetër politike e as në shoqëri të tjera, përveçse është Anëtar i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", që në themelimin e saj dhe për kontribut në realizmin e misionit të saj është nderuar me titull nderi: "Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini", me nr. 238, me 15 dhjetor 2017.

Në muajin mars 1957 është veshur në policinë e qytetit Shkodër dhe punoi deri në muajin shtator 1959.

Në vitin 1960 vijon punën në SMT-

Shkodër, në detyrën e llogaritarit.

Në muajin mars 1962 deri në muajin nëntor 1969 vishet në ushtri; me detyrë nënoficer në Shkodër, në një pjese kohe magazinier dhe pastaj llogaritar armatimi në Brigadën e Këmbësorisë, në Vau Dejës. Në këtë vit, me kërkesën e tij lirohet nga ushtria dhe vijon punën në SMT, në fillim në detyrën e specialistit të ndërtimit dhe më vonë në detyrën e përgjegjës të investimeve të SMT-s deri në vitin 1992, muaji prill. Gjate kohës së punës në SMT, në kohen e tërmetit të vitit 1979, është caktuar në detyrën e drejtuesit të eliminimit të pasojave të tërmetit për lagjen "Manush Alimani", "10 Korriku", "Ndoc Mazi", "Tre heroi", "Perlat Rexhepi", "Tome Kola" dhe "Skënderbeu".

Në këtë punë është dalluar dhe është dekoruar.

Në vitin 1958 pasaportizohet në qytetin e Shkodrës dhe po në këtë vit krijon familjen duke u martuar me

Gala Ram Geraj, bije nga Malësia e Madhe, rastësi e veçantë edhe Gala ishte rrite jetime. Me Galen patën tre fëmijë, dy djem e një vajzë:

Genci, i datëlindjes 1962, i martuar dhe ka tre vajza, është me banim në Bruksel;

Rita, e datëlindjes 1965, e martuar dhe ka një djalë dhe banon në Bruksel;

Tushi, i datëlindjes 1968, jeton në Belgjike.

Në moshën e re ka qene rapsod me emër për Shkodrën. Madje në festivalin e ushtrisë, në muajin korrik të vitit 1955, ka bere një këngë për Traktatin e "Varshavës" e ka kënduar me çifteli, është vlerësuar me vendin e pare.

Në vitin 1959, me ardhjen e Nikita Hrushovit në Shkodër, ka thur një këngë

kushtuar miqësisë me BRS dhe e ka kënduar me çifteli.

Në vitin 1965, me rastin e 10 korrikut, shkroi një këngë, të cilën e këndoi me çifteli dhe për këtë e publikuan në revistën "10 Korriku".

Pjetri ka thur shume rapsodi dhe novela.

Për këtë, ka botuar në dy vëllime:

1- "Rapsodi të shpirtit tim", në vitin 2014;

2- "Rikthim shpirtëror", në vitin 2019

Pjetri ishte aktiv në çdo veprimtari shoqërore, në veçanti që organizonte Shoqata Atdhetare "Dukagjini", virtytet e tij ishin të veçanta, ishte mjeshtër në tregimin e episodeve të veçanta, me një qetësi e këmbëngulje, për tu pasur lakmi nga dëgjuesit, ishte me një horizont të veçantë dhe bënte polemike në çdo fushe të jetës. Prandaj e kujtojmë dhe do ta kujtomë me nostalgji në takimet që do të kemi.

Te gjithë e donim ta kishim në mes nesh Pjetrin tonë, për intelektin e tij, për përkushtimin e tij, për fjalën e ëmbël dhe të qëndrueshme, për gjithçka që ka nevojë njeriu, por në mënyrë të veçantë djemtë, vajza, vëllai e motra, por kjo është jeta dhe duhet pritur e përballuar siç të vijë.

Në emër të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" ju shprehim ngushëllimet më të sinqerta, qofshi me jetë dhe e kujtofsh Pjetrin tuaj, Pjetrin tonë!

I lehte të qofte dheu Pjeter Gera!

I përjetshëm kujtimi i juaj Pjeter Gera!
Lamtumire Pjeter Gera!

NDUE SANAJ

Shkodër, me 29 tetor 2024

Në një vjetorin e ndarjes nga jeta të Zef Frrok Perndreu

(Fjala e rastit)

Të nderuar të pranishëm!

E nderuar bashkëshortja e Zefit, zonja Mire!

Të nderuar Gjovana, Jonisa e Denisi, fëmijët e Zefit!

Të nderuar Marku, Preçi, Gjini, Doda e Vitore, vëllezërit e motra e Zefit!

Jemi mbledhur në kuadrin e Një vjetorit të rënies në krye të detyrës aksidentalisht të Zef Frrok Perndreut, të bashkëshortit, të babait, të vëllait e shokut tonë!

Nje dhimbje e madhe për të gjithë, por kjo është jeta dhe jeta duhet të përballohet.

Nje personalitet shkruante: "Jo vetëm tani, por prej që e njoh vetën time zgjohem herët në mëngjes dhe e përqafoj jetën kështu siç është, i themi eja se të pres!

Eja se të pres, ashtu siç do ti, herë më gëzim në shpirt dhe herë me lot në sy!

I themi jetës, unë e kam fatin të të njoh kështu siç je, edhe kur ma falë befasia, edhe kur nuk më njeh.."

Ai burrë ishte krenar për jetën e tij, ju edhe ne duhet te jemi krenar për emrin e tij, por siç e citova më sipër fatet e jetës i cakton dikush tjetër

Kush ishte Zef Frrok Perndreu?

Zef Frrok Perndreu, ishte i datëlindjes 7 shkurt 1967, ishte fëmija i 6 i familjes prej 10 anëtareve të Frrok Prend Perndreu.

U lind dhe u rrit në fshatin Korthpule, të bashkisë Pukë, i banuar me popullsi mirditore.

Në moshën 16 vjeçare filloi të punoj në detyrën e ndihmës traktoristit, duke shënuar kështu dhe hapat e pare në karrierën e tij, në detyra të ndryshme traktorist, shofer dhe manovrator i mjeteve të

tonazhit të rende.

Zefi, rreth moshës 20 vjeçare dhe në vijim, sipas eksperiencës se punës, ai pajiset me të gjitha patentat e mundshme, fillon të punoj në SMT-në e asokohe derisa arriti të blej kamionin e tij të pare, duke punuar në mënyrë private.

Zefi, në vitin 1995 shpërngulet në Vau-Dejës dhe aty formon familjen me Mirën dhe sjell në jete 3 fëmijë, Gjovana, Jonida dhe Denisi.



Promovim i veçantë, për libër të veçantë.

"Gjurmë të Postës në trojet shqiptare 1800-1944"

U mbledhëm sot, me 12 tetor 2024 së bashku në tempullin e kulturës shkodrane e më gjerë dhe konkretisht te Biblioteka "Marin Barleti" për një promovim të veçantë e rreth një libri të veçantë, në të cilin pasqyrohet një nga profesionet mijërvjeçare siç është "lajmëtari i lashtësisë" e "postieri i sotëm" i ngritur institucionalisht nën termin Posta Shqiptare. E rëndësia i shtohet këtij materiali dokumentarë, kur gjurmët e saj shtrihen historikisht në mbarë trojet tona.

Ne jemi me fat që i kemi në mesin tonë njerëz të tillë siç është bashkëmalësori ynë e intelektual i mirënjohur Fadil Smajlaj, i cili i bën nderë gjithë shqiptarisë, duke "sjellë në jetë" një botim tepër të veçantë çka radhë mund ta hasësh në ditët e sotme "intelektualë" apo "profesionalistë të modeleve të ndryshme".

Moderimi profesional i kësaj veprimtarie promovuese nga e nderuara Albana Kraja si dhe opinionet e sjellura me mjaftë kulturë nga intelektual i biznesmeni i mirënjohur, Gjergj Leqejza, Konsull Nderi i Austrisë në Shkodër, Profesori i Universiteti Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Ervis Krymbi dhe miku i librit dhe i vetë autorit, Sytqi Ndrecaj si dhe përshëndetja e autorit të librit "Gjurmë të postës në trojet shqiptare 1800-1944", Fadil Smajlaj krijuan fizionominë e plotë të objektit e subjekti të librit, por edhe prania e shumë personaliteteve të fushave të ndryshme si Prof. Dr. Adem Bekteshi, Besnik Fishta; Kryetari i Shoqata Atdhetare "Dukagjini", Ndue Sanaj; poetja Mimoza Rexhvelaj; këngëautori Gjon Kosteri, Administratori i Nj. A. Gruemirë, Ismet Sylaj Osja; Drejtori Rajonal i Postës Hilmi Lakti e të tjerë, e të tjerë.

Me pjesëmarrjen e pasqyrimin mediatik nëpërmjet gazetarëve Musa Kurtulaj, Bepin Kolvata, Klodian Zhivani, Senad Nikshiqi, Pëllumb Sula e të tjerë, si dhe familjarë e të afërm, miq e kolegë të Fadilit u krijua një "ansambël i përkryer" vlerash.


Askush nuk u ndie i veçuar, të gjithë kontribuan në krijimin e një mjedisi sa më mrekullues, duke uruar autorin e mikun tonë të përbashkët Fadil Smajlaj, suksese e vijimësi të punës, për ti dhënë Postës Shqiptare identitetin e plotë deri në ditët tona.

U mbledhëm sot, me 12 tetor 2024 së bashku në tempullin e kulturës shkodrane e më gjerë dhe konkretisht te Biblioteka "Marin Barleti" për një promovim të veçantë e rreth një libri të veçantë, në të cilin pasqyrohet një nga profesionet mijërvjeçare siç është "lajmëtari i lashtësisë" e "postieri i



sotëm" i ngritur institucionalisht nën termin Posta Shqiptare. E rëndësia i shtohet këtij materiali dokumentarë, kur gjurmët e saj shtrihen historikisht në mbarë trojet tona.

Ne jemi me fat që i kemi në mesin tonë njerëz të tillë siç është bashkëmalësori ynë e intelektual i mirënjohur Fadil Smajlaj, i cili i bën nderë gjithë shqiptarisë, duke



"sjellë në jetë" një botim tepër të veçantë çka radhë mund ta hasësh në ditët e sotme "intelektualë" apo "profesionalistë të modeleve të ndryshme".

Moderimi profesional i kësaj veprimtarie promovuese nga e nderuara Albana Kraja si dhe opinionet e sjellura me mjaftë kulturë nga intelektual i biznesmeni i mirënjohur, Gjergj Leqejza, Konsull Nderi i Austrisë në Shkodër,

Profesori i Universiteti Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Ervis Krymbi dhe miku i librit dhe i vetë autorit, Sytqi Ndrecaj si dhe përshëndetja e autorit të librit "Gjurmë të postës në trojet shqiptare 1800-1944", Fadil Smajlaj krijuan fizionominë e plotë të objektit e subjekti të librit, por edhe

prania e shumë personaliteteve të fushave të ndryshme si Prof. Dr. Adem Bekteshi, Besnik Fishta; Kryetari i Shoqata Atdhetare "Dukagjini", Ndue Sanaj; poetja Mimoza Rexhvelaj; këngëautori Gjon Kosteri, Administratori i Nj. A. Gruemirë, Ismet Sylaj Osja; Drejtori Rajonal i Postës Hilmi Lakti e të tjerë, e të tjerë.

Me pjesëmarrjen e pasqyrimin mediatik nëpërmjet gazetarëve Musa Kurtulaj, Bepin Kolvata, Klodian Zhivani, Senad Nikshiqi, Pëllumb Sula e të tjerë, si dhe familjarë e të afërm, miq e kolegë të Fadilit u krijua një "ansambël i përkryer" vlerash.

Askush nuk u ndie i veçuar, të gjithë kontribuan në krijimin e një mjedisi sa më mrekullues, duke uruar autorin e mikun tonë të përbashkët Fadil Smajlaj, suksese e vijimësi të punës, për ti dhënë Postës Shqiptare identitetin e plotë deri në ditët tona.

Respekte e suksese përherë!
SYTKI NDRUCA



pista e garave në Elbasan, rruga Ura-Dervishbeg Shkodër dhe se fundmi në konstruksionin e rrugës së Dukagjinit, ku dha dhe frymën e fundit, me 12 tetor 2023.

Zefin e donim ta kishim përsëri e përsëri midis nesh, në veçanti familja, të afërmit, por dhe shoqëria, të gjithë ne, për djersen e tij, për mendjen e tij dhe për gjithçka që ka jeta! Por ja, që jeta nuk është në dorën tonë, ajo është në dorën e tjetër kujt dhe atij i qofshim falur, Zotit,

krijuesit të gjithësisë!

Dukagjinasi sa herë të kalojnë nga ajo rrugë do ta kujtojnë me dhimbje respekt dhe krenari për të ndjerin Zef Frrok Perndreu

Prandaj..!

Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", bazuar në gjitha këto virtyte dhe kontribute, vendosi: Te nderoj Zef Frrok

Perndreu, me titullin e lartë "Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini",

me motivacion:

Në respekt të punës dhe jetës tuaj që u flijuat në Trojet e Dukagjinit, duke punuar në rrugën e Dukagjinit. Vëlla i dashur Mirditor ju ishit shembull i burrnisë dhe respektit për të gjithë ata që të kanë njohur dhe punuar me Ju. Bashkësia Dukagjinit jeton me dhimbjen e familjes suaj, sepse Ju do të jeni gjithmonë "Anëtar Nderi i

Shoqatës Atdhetare Dukagjini"

I përjetshëm qoftë kujtimi juaj!'"!

I përjetshëm kujtimi i Zef Frrok Perndreut! Zoti ju bekoftë dhe ju nderoftë familjarisht!

Ndue Sanaj,
me 12 tetor 2024

SFIDANTI MARK PALNIKAJ

Sot, me 5 tetor 2024, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë në Tiranë, e premtë 5 tetor 2024, aktivitet shumë mbresëlënës me rastin e 70-vjetorit të lindjes të z. Mark Palnikaj, ku pjesëmarrja e auditorit ishte e gjerë, shumë cilësore dhe elitare.

Përveç shokëve, miqve e familjarëve të Markut në sallën tejet të mbushur ishin prezent edhe personalitete të spikatura me tituj të lartë hierarkie shkencore, në fusha të ndryshme të studimeve historike, albanologjike, arkeologjisë, pedagogë e profesorë të universiteteve, shkrimtarë e poetë dhe të tjerë, individ të shquar në punë e në jetë, të moshave e profesioneve të ndryshme, të cilët e kanë ndjekur në vazhdimësi angazhimin e punën e jashtëzakonshme të z. Mark ndërvite.

Hapjen e drejtimin e gjithë veprimtarisë e bëri me cilësi të lartë intelektuale profesor Lulëzim Logu.

Fjalën kryesore në këtë aktivitet e mbajti studiuesi e historiani (autor i shumë botimeve) z. Nikoll Loka, i cili kishte bërë një përmbledhje të detajuar e shumë cilësore, për jetën, shkollimin, angazhimin profesional në shtet, jetën e aktivitetin privat, familjen e angazhimet familjare të Tij, privacionet shëndetësore e sidomos angazhimin e punën e jashtëzakonshme në fushën e hulumtimeve, studimeve në arkivat brenda e jashtë shtetit, në fushën e historisë dhe botimeve të shumta e tepër të rëndësishme për historinë e kulturën shqiptare, që nga mesjeta e deri në ditët tona.

U theksuan aty edhe titujt e nderimet e akorduara ndër vite nga institucione shtetërore, organizata shoqërore e fondacione të ndryshme, të cilat në total shkonjnë mbi njëzet, të tilla për z. Mark Palnikaj.

Me këtë rast, në mënyrë simbolike Markut ju dorëzua edhe "Bekimi Apostolik i Papa Françeskut", i akorduar me rastin e 70 vjetorit të Tij, nga Prof. Dok. Angjelin Shtjefni.

Me shumë interes e duartrokitje të fuqishme nga te pranishmit u pritën fjalët përshëndetëse me shumë vlerësime pozitive, për angazhimin e jashtëzakonshëm e punën tepër frytdhënëse në fushën e studimeve historike të Tij nga Prof. Dr. Pëllumb Xhufi; Akademik Prof. Dr. Neritan Ceka; Akademik Prof. Dr. Besnik Bare e të tjerë, që morën fjalën në këtë veprimtari dhe sikur të kishte më shumë kohë në dispozicion shumë nga të pranishmit do merrnin fjalën, për të shprehur vlerësimin e lartë e dashamirësin e madhe ndaj Markut e punës së Tij.

Në diskutimet e tyre u vlerësuan shumë angazhimet e hulumtimet e bëra prej Tij, në arkivat jashtë vendit, si në Vatikan; Grotoferrata; Napoli; Venedik; Fermo e të tjera, të cilat përfshijnë shkrime, studime e dokumentime të shekujve XV deri XX-të.

Opinione e vlerësime shumë pozitive nga folësit u bënë edhe për bashkëpunime, shumë të frytshme me personalitet e specialistë të mirëfilltë të kësaj fushe, si brenda e jashtë vendit.

Në mbyllje të veprimtarisë e mori fjalën

vetë z. Mark, i cili përshëndeti e falënderoi me shumë përzemërsi të gjithë pjesëmarrësit në këtë veprimtari, me rastin e 70 vjetorit të lindjes së Tij.

Me këtë rast, Ai prezantoi edhe botimet e bëra në vitet e fundit duke cilësuar, në



thelb secilën prej tyre, se nga janë nxjerrë, përmbajtjen e rendësin e tyre e duke theksuar me të madhe, se ka edhe disa botime të reja në zhvillim e sipër dhe mijëra faqe të tjera të grumbulluara e sistemuara, të cilat presin përkthimin e sistemimin e tyre për botim dhe për t'ju u dhënë për njohje e studim publikut të gjerë.

Vlerësim i veçantë u bë për përkthimin nga origjinali i këtyre dokumenteve, të cilat kanë dashur, jo vetëm angazhimin e Tij, por dhe bashkëpunimin me shumë studiues e përkthyes brenda e jashtë vendit.

Personalitetet, që morën fjalën theksuan se, Marku, me hulumtimet, studimet e botimet e Tij ka hedhur një dritë të re mbi shumë ngjarje e personalitet të kësaj periudhe disa shekullore, të cilat kanë qenë të mbuluara nga pluhuri i harresës në mbarë trojet shqiptare dhe sidomos për trevat veriore, të cilave historiografia shqiptare ju ka borxhe për mos pasqyrimin e tyre.

Marku me shumë sukses ka përvetësuar e shfrytëzuar zhvillimet e reja teknologjike dhe programet kompjuterike, që i ka përdorur në shërbim të angazhimeve të tij studimore.

Si profesionist i lartë në ndërmarrjet shtetërore, Ai arriti deri në detyrën e k/inxhinierit në parkun automobilistik të rrethit Tropojë.

Kalimi i Markut në veprimtari private duhet theksuar, se ka qenë shumë i suksesshëm.

Autoshkolla "PALNIKAJ" e krijuar e ngritur prej Tij u kthye shumë shpejt në shkollë për autoshkollat mbarëkombëtare, si brenda e jashtë Shqipërisë. Dokumentet (tekstet) e hartuara e të botuara nga Ai, u bënë literaturë e domosdoshme dhe shumë e rëndësishme për të gjithë autoshkollat e kursantët e tyre, të cilat vijojnë të përdoren e shfrytëzohen edhe sot e kësaj dite.

Në këtë takim përshtypje të veçantë bëri për të gjithë të pranishmit konstatimi se, studimet, dokumentimet e botimet e Mark Palnikajt në fushën e historiografisë

janë kthyer në një referencë shumë të rëndësishme, të cilat citohen nga studiuesit tanë më në zë të sotëm.

Një fakt, i cili duhet veçuar në këtë veprimtari është ai se, të gjithë ata që folën e përshëndetën treguan anën e tyre



shumë njerëzore, duke e dhënë me shumë dashamirësi Markut porosinë e kujdesit në radhë të parë për jetën e veten e tij, në ruajtjen e shëndetit dhe sigurimin e një jetëgjatësie, sa më të madhe.

Në fund të veprimtarisë, familja e tij ftoi gjithë të pranishmit në një koktejt, të shumëllojshëm dhe të plote, ku gjithsecili e uroi me shumë përzemërsi z. Mark për shëndet, sa më të mirë e jetë, sa më të gjatë, për gëzime e lumturi të përhershme familjare dhe suksese gjithnjë në rritje në angazhimet intelektuale të Tij, kaq me vlerë e të rëndësishme për historinë e kulturën tonë Kombëtare.

Duhet theksuar se, para disa ditësh Marku 70-vjetorin e lindjes së Tij e ka festuar edhe në Prishtinë, me një pjesëmarrje elitare të personaliteteve të Kosovës, si profesorë, politikanë, ushtarakë të lartë, ish Presidentë e klerikë, veprimtari, në të cilin ato i kanë dhuruar vlerësim, dashamirësi e mirënjohje të lartë për angazhimet e tij edhe për historiografinë e Kosovës.

Unë, duke e njohur shumë mirë nga afër, në gjithë udhëtimin e Tij jetësorë nuk mund të kaloj pa theksuar, se Marku në angazhimin e përballimin e problemeve familjare është treguar, jo vetëm tepër i përgjegjshëm, po dhe shumë i suksesshëm.

Ai mbeti kryefamiljarë në moshë shumë të re, pasi babai i tij ndërroi jetë (nga sëmundje e rëndë), kur Ai ishte student në vitin e dytë.

Motrat e vëllezërit ishin të gjithë me të vegjël dhe shto këtu edhe hallet ekonomike të kohës.

Në përballje me pengesat e kohës, me zgjuarsinë e finesën e Tij arriti t'ju siguronte atyre shkollën e mesme e të lartë.

Sot, ata janë të gjithë individ e familjarë të plotësuar e stabilizuar, secili më mirë se tjetri.

Një fatkeqësi e barrë e madhe për Markun ishte edhe ndarja nga jeta e bashkëshortit të motrës së madhe (në një aksident automobilistik), duke e lënë në

moshë shumë të re me fëmijë jetim.

Ai, jo vetëm nuk u distancua, por e mori atë bashkë me fëmijët për disa vite në shtëpinë e Tij dhe jetuan së bashku, si një familje. Falë këtij angazhimi, Ajo arriti të rrisë fëmijët, si më të mirët dhe sot janë të stabilizuar me punë e jetesë.

Por, Marku duhet theksuar, se ishte edhe me shumë fat në jetë, pasi lidhi jetën me intelektualen e vajzën e nje familje tërësisht intelektuale e shumë dinjitare. Prena, bashkëshortja e Markut e dalluar për kulturën e thjeshtësinë e saj, i është bërë, jo vetëm krah i fuqishëm në jetë, po ka shtuar edhe vlerat e krenarin e Markut.

Ato lindën, rritën dhe shkolluan dy djem të mrekullueshëm, secili më i mirë se tjetri.

Dritani jurist, me mbi 12 vjet karriere të suksesshme në strukturën më të lartë të shtetit dhe Skerdi inxhinier mekanik, i cili ka dhënë e vijon të japë prova shumë të mira në angazhimet e vendet e punës të deritanishme. Domosdo prindërit e tyre Marku e Prena janë shumë të lumtur e krenar për fëmijët e tyre, por edhe djemtë e tyre janë shume te lumtur e ballëlartë për të dy prindërit e tyre.

Sa shumë kam për të folur e shkruar për jetën, sfidat, përballjet e sukseset në jetë te shokut tonë Mark Palnikaj...

Ai, si vlerë të shtuar jetësore e njerëzore ka se, ka qenë e mbetet shumë, i thjeshtë, tepër komunikues e dashamirës me të gjithë njerëzit, që e ka bashkuar e lidhur puna e jeta.

Këtë shkrim, prandaj e titullova me titullin "S F I D A N T I" me bindje të plotë, me shumë dashamirësi e respekt për Markun.

I tillë është përballuar, treguar e realizuar, në të gjitha planet jetësore, duke u treguar inteligjent, super i vullnetshëm, këmbëngulës e i paepur në përpjekjet, synimet dhe realizimet e Tij familjare, profesionale e intelektuale.

U zgjata shumë, por kam lënë edhe shumë fakte e detaje domethënëse pa pasqyruar për jetën e veprimtarinë e Mark Palnikajt, i cili e nisi jetën e tij me shumë halle nga fshati, gjithnjë duke shkëlqyer, si individ dhe sot arrin të gëzojë "MIRENJOHJEN" e Atit të Shenjtë Papa Françesku.

Mbetet vetëm t'i urojmë shumë përzemërsisht Markut shëndet e jetë sa më të gjatë, i mbuluar nga gëzimi e lumturia familjare dhe suksese në vijimësi e gjithnjë në rritje në misionin e Tij shumë fisnik e atdhetarë.

Kurrsesi nuk mund të anashkalojmë, pa evidentuar faktin tepër të rëndësishëm e shumë domethënës, se gjithë ky angazhim hulumtues e studimor i Markut brenda e jashtë shtetit realizohet në mënyrë vullnetare dhe vetëm me shpenzimet e Tij, pa asnjë përkrahje institucionale dhe as financiare të shtetit Tonë dhe as të Kosovës.

Ky fakt flet më së miri për ndjenjën e lartë të atdhetarizmit e idealizmit të z. Mark.

Tashmë, Ju nuk jeni vetëm krenari e familjes e krahinës, por personalitet e krenari Kombëtare.

Dedë ZHIVANI.

Shkoder, më 5 tetor 2024

Prof. Dr. MARK TIRTA, AKADEMIKU I ETNOKULTURES, NJË EMËR I NJOHUR I SHKENCËS SHQIPTARE DHE MË GJERË

Mesazh urimi me rastin e dhënies se titullit të lartë "Nder i Kombit" dhe dekorimi nga Presidenca e Kosovës "Medalja Presidenciale e Meritave", me motivacionin për "Punën e jashtëzakonshme në mbledhjen e materialeve etnografike e folklorik dhe zbulimin e qendrave të reja arkeologjike për Arbërinë mesjetar"

Të shkruash për intelektual të përkushtuar e me integritet, nuk është e lehtë, pasi tek ata mungon dëshira për dukje, por kanë me shumicë, ndjenjë, pasion, dashuri e humanizëm, gjëra të cilat ne i kërkojmë tek "heronjtë". Por në të vërtetë, "heronjtë" janë njerëzit e thjeshtë, të ditur dhe të përkushtuar, që tërë jetën e tyre sakrifikojnë për një qëllim, për një ideal, dhe bëjnë të pamundurën për t'i realizuar, qoftë dhe me vetëmohim.

Le të ndalemi tek njeri prej atyre njerëzve të sakrificës, të përkushtimit, të vetëmohimit dhe të pastërtisë morale, i tillë është portreti i profesorit, akademikut tonë të nderuar dhe të respektuar Mark Tirta.

Ai është një burrë i zakonshëm, i thjeshtë, i buzëqeshur, pavarësisht nga vitet që ka mbi supe, Mark Tirta është stoik në qëndrimet e tija, ndoshta moshë dhe sëmundja e kanë lodhur, por shpirti i tij mbetet gjithnjë i ri, modest dhe plot dashuri për shkencën, për artin e kulturën, për njerëzit.

Vepra shumëplanëshe e Akademik Tirtes meriton respekt dhe përlujë para Tij, para studimeve të Tija, para kontributit të jashtëzakonshëm që ai ka dhënë në shkencat albanologjike dhe sidomos në etnokulturë.

Mark Tirta ka mbi shtatullat e Tija 87 vjet jetë njerëzore, por edhe rreth 67 vjet punë kërkimore-shkencore, punë e cila e kanë radhitur profesor Markun ndër personalitetet më të shquara të shkencës shqiptare dhe më gjerë. Si studiues i talentuar, Ai gjithçka e arriti me punë këmbëngulëse dhe me plot vullnet e dije shkencore dhe ishte rezultat i punës së Tij çdo arritje. Në vitin 2020, doktorant Nikoll Loka, me rastin e 85 vjetorit të lindjes së profesor Tirtes, shkruan: "E papritura e parë e jetës: Marku e nisi rrugën e dijes në një mënyrë krejt të veçantë. Fillimi i tij nuk lidhet me një mësues të zakonshëm, as me një klasë, por si nxënësi i një kleriku, që do t'i jepte bazat fillestare për të vazhduar Seminarin Papnor në Shkodër. Abati Frano Gjini, duke pasur konsideratë për të atin, mendon që njëri nga djemtë të ndiqte rrugën e meshtarisë. Babai, pasi vjen në shtëpi dhe e pleqëroi kërkesën në familje, vendos që ta dërgonte pikërisht Markun, me arsyen e vetme se "ky për punë nuk ban, ishalla ban për kalem!" Profecia e të atit doli, Marku nuk zhgënjeu. Mësuesi i parë i Mark Tirtes ishte Dom Mark Gjini, i diplomuar për teologji-filozofi në Universitetin 'Antonianum' të Romës. Me Dom Markun djali zhvilloi lëndët: shkrim, këndim, aritmetikë nga katër herë në javë me dy orë mësim në ditë. Për të shkruar në shkollë, bënte katër orë rrugë në këmbë vajtje-ardhje nga Lgjinë deri te Abacia në Orosh; kishte lodhje, ndodhte që të shkonte nëpër shi dhe borë, terreni ishte i vështirë dhe sikur të mos mjaftonte kjo, kishte shpërthyer lufta e pas njëfarë kohe, mbi qiellin e Oroshit nisën të kalonin avionë të palëve ndërluftuese. Në ato kushte, ndërpreu mësimet, ndërkohë që nuk kishte një ëndërr tjetër në sirtar. Marku ka dhe një koincidence tjetër, i takoi që të jetonte në mes të librave. Biblioteka i erdhi dhuratë nga dajti prej Kryezezit të Malësisë së Lezhës. Pas vdekjes së dy vëllezërve të nënës që kishin shkollë, librat e tyre nuk kishte kush t'i lexonte, prandaj u dërguan për dy vëllezërit e Markut, Pjetrin dhe Gjonin që kishin kryer shkollën fillore.

Edhe pse ende nuk dinte të lexonte mirë, Marku i kalonte librat nëpër duar dhe mendonte që sapo të hapeshin shkollat, të shkonte e të mësonte që të mund t'i lexonte".

Marku i vogël, shkollën fillore e mbaroi shkëlqyeshëm. E kishte me pasion shkollën. Vijoi më vonë 7-vjeçaren në Durrës, në vitet 1948-1950. shkollën e Mesme Pedagogjike e mbaroi në Tiranë. Tani para tij dhe familjes së tij kishte dy alternativa: i duhej të zgjidhte të bëhej një rrogëtar e të ndihmonte familjen me rrogën që do të merrte, apo të vazhdonte



Prof. Dok. Mark Tirta,
Akademik - "Nder i Kombit"

dhe dy vite të tjera shkollë të lartë që të formohej plotësisht. Me pëlqimin dhe besimin e familjes, zgjodhi të vijonte studimet e larta në Institutin e Lartë Pedagogjik 2-vjeçar të Shkodrës. Më vonë, gjatë punës, plotësoi dhe studimet katërvjeçare në Fakultetin Histori-Filologji në Tiranë. Prof. Dr. Mark Tirta, etnolog, akademik i Asociuar (2008), lindur në Orosh të Mirditës, më 21 maj 1935, kryen studimet në Universitetin e Shkodrës e të Tiranës për histori-gjuhësi, më 1957 - 1961. Në vitet 1955-1957 dhe 1959-1967 ka qenë mësues në Mirditë: më tepër drejtor shkolle a inspektor arsimit (për rrethin e Mirditës). Nga viti 1961 e në vijim, krahas punës në arsim, merrte dukshëm me kërkime në fushë të etnokulturës, bën eksplorime të shumta në Mirditë e rrethet fqinje të saj, si: mbledhje materiali etnografik e folklorik, zbulon e përshkruan qendra të reja arkeologjike të Arbrit Mesjetar, po kështu dhe kulturë ilire e romake, ngriti një muze në Rrëshen (1967), mbledh toponime, antroponime, fjalë të rralla. Botoi shkrime të ndryshme. Ka bërë një fjalor me 6500 toponime të Mirditës, depozituar në Arkivin e Institutit të Gjuhë-Letërsisë. Si rrjedhojë e kësaj pune kërkimore, më 1968 e emërojnë etnolog profesorist në Tiranë, në Institutin e Histori-Gjuhësisë, dega e etnologjisë, (sot: Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë), punë që vijon ta kryejë edhe në ditët e sotme, edhe pse ka dalë në pension më 2008.

Më 1967-1968 ka kryer në Tiranë një kurs njëvjeçar për filozofi, si kualifikim pasuniversitar. Titujt e gradat shkencore: më 1968, për veprimtarinë shkencore si bashkëpunëtor i jashtëm për 7 vjet, i është dhënë titulli "Bashkëpunëtor Shkencor i Ri"; më 1978 ka mbrojtur disertacionin në mitologji e besime e ka fituar gradën "Kandidat i Shkencave"; më 1983 i është dhënë titulli "Bashkëpunëtor i vjetër shkencor"; më 1988 me temën "Migrime të Shqiptarëve": disertacion, ka fituar gradën "Doktor i Shkencave"; më 1994 i është dhënë titulli "Prof. Dr." ("Drejtuës kërkimesh"). Është bërë Akademik i asociuar (2008). Në vitet e para, pasi është emëruar etnolog në Tiranë, ka dhënë këto provime pasuniversitare:

1. Etnologji e përgjithshme,

2. Etnologji evropiane, kur përqendrimi ka qenë dukshëm te Ballkani,

3. Etnologjia shqiptare,

4. Filozofi: ka shërbyer diploma e kursit të përmendur më sipër.

Më 1971 ka qenë 4 muaj për specializim në muzeologji në Rumani e në Itali. Një mirë gjuhën frëngjisht, rusisht, italisht, serbokroatisht; për të tëra ka dhënë provime pasuniversitare. Ka botuar në vende të huaja mbi 70 shkrime shkencore. Në Spanjë, në Francë e në Gjermani i janë kërkuar për botim librat, si: "Mitologjia ndër Shqiptarë" e "Etnologjia e Shqiptarëve", po nuk u bënë. Ky etnolog disponon disa letra e kërkesa të bëra nga Instituti i Evropës Juglindore në Vjenë, ku ftohet të bashkëpunojë në tema të popullsisë e të disa çështjeve të tjera etnologjike për Shqipërinë në një vepër madhore të këtij Instituti. I kanë kërkuar bashkëpunim për vepra madhore të emigracionit botëror të sotëm, për të bërë pjesën për Shqipërinë: Universiteti i Floridas në SHBA, një Universitet i Torontos (Kanada), një koleg ushtarak i studimeve gjeografike në Kanada. Tërë këtyre të fundit nuk u kanë dhënë përgjigje pozitive për të mos u spostuar nga temat në studim, por dhe për mungesë të mjeteve financiare që fillimisht i duheshin për të plotësuar harta, skica, grafikë e gjëra të tjera teknike. Më 1988, këtij etnologu, i është kërkuar të plotësojë Curriculum Vitae e disa dokumente të tjera, por dhe një konfirmim vetjak pranimit, për t'u bërë anëtar i Akademisë Ndërkombëtare të Shkencave të Lutesës (Paris), por bashkë me dokumentet duheshin dërguar dhe një sasi dollarësh si test miratimi që i përmenduri nuk i dispononte; në bazë të statusit të kësaj Akademie duheshin paguar dhe kuota mujore, të shprehura në dollarë, gjë që ishte e pamundur të bëhej. Si rrjedhojë, kërkesën e ktheu mbrapsht me një falënderim mirësjelljeje ndaj atyre që ia propozuan këtë titull.

Ka qenë anëtar i redaksisë së përmbledhës "Etnografia shqiptare" dhe i revistës "Kultura popullore", përkatësisht dhe i "Ethnographie Albanaise" e në "Culture populaire albanaise", në këtë të fundit, "Kultura Popullore", që në themelimin e saj.

Në përgatitje të çdo numri të tyre ka dhënë një ndihmesë të shënuar me artikuj studimorë, me recensionë librash, me informacione shkencore, me redaktime, me zgjedhje dhe përpunim materiale për revistën dhe përmbledhësin. Si etnolog, prej shumë vitesh ka ndërmarrë ekspedita kërkimore në tërë viset shqiptare, duke përfshirë edhe Kosovë e Maqedoni Perëndimore, dëshmi që i kanë vlejtur në punën e tij studimore, si themel mbështetës në punën e tij shkencore. Ka shkruar mbi 400 punime shkencore e kulturore në fushë të etnologjisë shqiptare e më tej, kryesisht nga temat: mitologji e besime, migrime të shqiptarëve, por është marrë dhe me temat: familja, arti popullor, e drejta kanunore, jeta sociale e fshatarësisë, veshjet popullore, toponimet në vështrim etnologjik, probleme të zhvillimit krahinor e etnik të shqiptarëve, histori e etnologjisë e njerëz të shquar, kritikë e bibliografi. Jo pak punime të këtij etnologu janë botuar në gjuhë të huaja, madje edhe në disa revista e periodikë prestigjiozë shkencorë në botën e jashtme, gjithsej mbi 70 punime shkencore. Ky etnolog ka marrë pjesë me kumtesa, me referate, në sesione shkencore, në simpoziume, në konferenca, në kongrese shkencore, kombëtare e ndërkombëtare, brenda vendit e në botën e jashtme,

në mbi 130 raste. Është marrë dukshëm me muzeologji: në ekspozita e muze në Tiranë, në rrethe të ndryshme të vendit, në ekspozita muzeale e veprimtari jashtë shtetit. Ka botime shkencore jashtë shtetit, mbi 70 njësi, shkrime shkencore, përfshirë dhe Kosovën e Maqedoninë. Ka bashkëpunuar në bërje të veprave madhore, si: "Qytetërimi Ballkanik" nën kujdesin e UNESCO-s; po kështu në "Atlasi i vendeve danubiane", - drejtuar nga Instituti i Studimeve për Evropën Juglindore, në Vjenë. Në botimet madhore të Shqipërisë ka bashkëpunuar në: "Shpati i Sipërm" (i Elbasanit), "Fjalori enciklopedik shqiptar", "Veshjet popullore shqiptare", "E drejta kanunore shqiptare", "Shpërngulje me forcë e qëndresë e Kosovës martire" (1998-1999); "Hasi në etnokulturën shqiptare", "Himara në shekuj", "Migrime nga fshatrat malore-kodrinore për në vendet paraurbane e urbane (1991-2007)" e me radhë. Ka disa shkrime shkencore në botime e periodikë të ndryshëm të Lezhës e të Mirditës. Është bashkautor i monografisë "Mirdita. Njohuri për vendlindjen" (1999). Ka në përgatitje për botim librat: "Etnologjia e Mirditës", "Fjalori mitologjik shqiptar", "Etnologjia e Evropës Juglindore dhe e Mesdheut". Prej shumë vitesh ka dhënë lëndët e etnologjisë në Universitetin e Tiranës, në degët histori, sociologji. Ndër to, për tre vjet dhe në "Mitologjia" ka dhënë mësim edhe në degën e gazetarisë. Prej shtatë vitesh ka ligjruar lëndën "Etnologjia e Evropës Juglindore dhe e Mesdheut" në Universitetin e Prishtinës. Ka udhëhequr studiuesit e rinj, si mentor, në marrje të gradave shkencore: mastër e doktor i shkencave. Në arsimin pasuniversitar ka bërë programe e ka organizuar provimet në lëndët e specialitetit të etnologjisë. Veprat e tij kryesore janë: "Migrime të Shqiptarëve" (1999), "Veshjet popullore shqiptare" (me bashkautorë), VI (1999), VII (2001), VIII (2016), "Etnologjia e Përgjithshme" (2001, 2008), "Etnologjia e Shqiptarëve" (2003, 2006), "Mitologjia ndër Shqiptarë" (2004), "Lëvizje migruese të brendshme ndër Shqiptarë" (2013), "Mjeshtëria e kërkimit shkencor në etnologji" (2006), "Panteoni e simbolika, doke e kode..." (2007), "Etnokultura Shqiptare-Ligji Dokesor" (2016). Është vlerësuar me shumë tituj e dekorata të ndryshme, për punën e bërë në studimet shkencore. Edhe në ditët e sotme vazhdon të shkruajë e të botojë studime shkencore e kulturore në etnologji, po kështu dhe të botojë libra të natyrës shkencore e kulturore ashtu si dhe më parë. Çdo vit ka botuar (duke përfshirë dhe vitin 2018) nga 8 deri 12 shkrime të natyrës shkencore-kulturore. Ka hartuar në këto vitet e fundit dhe 152 zëra për Fjalorin Enciklopedik të Mirditës. Së fundmi është dekoruar dhe nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë me titullin "Nderi i Kombit", "Në shenjë vlerësimi dhe mirënjohjeje për zhvillimin e shkencës së etnologjisë në vendin tonë; për periodizimin e etnologjisë shqiptare në shtatë pjesë që nga lashtësia e deri më sot, si dhe për vënien e disiplinës së etnologjisë në një shkallë me nivelin e kësaj shkencë në rajon dhe në botë." Të gjithë miqtë dhe shokët e tij kudo që janë, i urojnë sot shëndet dhe vetëm shëndet, pleqëri të mbarë, jetë dinjitoze burrit të vlerave e virtyeteve të larta njerëzore. Veprat e tij kanë qenë edhe janë e do të jenë udhërrëfyese për brezat e ardhshëm të shkencëtarëve shqiptarë dhe më gjerë.

FRAN GJOKA

“VELLOJA E KRYQËZUAR” - roman i autorit Prend Ndoja

Autori nga Kosova, Prend Ndoja, na sjell një rrëfim krejt të veçantë për peripecitë, ankthin dhe dhunën nëpër të cilat kaloi Kosova dhe njerëzit e saj para dhe gjatë luftës së fundit. Përmes fatit të dy të rinjve të njohur mes tyre që kur ishin fëmijë, të përfshirë në vorbullën e pamëshirshme të përndjekjeve dhe të luftës, shpërfaqen dimensionet e tmerrshme të gjithë asaj katrahure me të cilën u përballën shqiptarët e Kosovës: egërsia e pushtuesit serb, terrori ndaj popullatës vendase, përkushtimi i veprimtarëve të shumtë, vendosmëria e luftëtarëve për të mbrojtur vendin me armë, heroizmi i paskajshëm i burrave e grave, dhe vetëmohimi sidomos i grave në përballje me ruajtjen e nderit personal dhe të familjes përballë barbarëve të policisë dhe ushtrisë së etur për të vrarë, djegur e dhunuar gjithçka.

Djali (Lisi) dhe vajza (Era) duhen me një idealizëm të qashtë e përkushtim të thellë, ndërkohë që Kosovës i afrohet gjithnjë e më shumë ora e saj më e ligë. Me gjithë ëndrrat dhe dëshirën e pakufishme të dy heronjve për mbijetesë, gjaksorët janë të tillë që shkretojnë kudo ku vënë këmbën. Vello e brishtësisë dhe pafajsisë së dy të rinjve të dashuruar, në nisje është një synim përtej romancës. Ajo mbetet deri në fund një vello e bardhë duke i dhënë dashurisë vlerë hyjnore, edhe përtej jetës. Pavarësisht se të gjitha rrethanat e krijuara më vonë nuk lënë vend për asnjë shenjë nusërimi dhe realizimi të jetës së tyre çiftore, kulmon qartë porosia e mbrojtjes së nderit me të njëjtën fuqi si për mbrojtjen e identitetit. Që të dyja këto, nderi dhe identiteti, duhen mbrojtur me jetë!

Vala e shkrimit romanor zgjerohet në veprime e në hapësirë. Lisi, i detyruar të largohet nga Kosova për shkak se ka rënë në sy të policisë serbe e cila së shpejti do t'i kanoset me arrest dhe burgim, merr me vete gjithë dashurinë e vajzës së ëndrrave të tij jetësore, Erës. Nga ana tjetër, zerra e Erës është aq e dliresë sa s'ka regjim e pushtet ta ndajë nga gjysma e zemrës së saj, që tashmë detyrohet të largohet përtej oqeanit. Sa më e madhe largësia, aq më e fuqishme dashuria. Dy qeniet tashmë kanë vetëm një zemër për të cilën janë në gjendje edhe të vdesin.

Paralelisht me gjithë trajtimin e rrëfimit, autori shfaq me mjeshtëri një lëndë prozaikë të organizuar qartë. Dy të dashuruarit do të kujdesen deri në detaje për finalizimin e lidhjes së tyre. Pasi i japin besën njëri-tjetrit, pasi marrin bekimin e familjeve, ata shkojnë të porosisin vellon e cila këtu nuk simbolizon thjesht ditën e martesës, as vetëm nusen e veshur me ta bardha, por pastërtinë dhe dliresinë e gjithçkaje në veten e tyre, përfshirë këtu edhe kodin moral shqiptar të besës dhe pastërtisë ndjesore, fizike e morale. Pikërisht kjo dliresë i bën të jenë heronj të ditë-netëve më tragjike që përjetoi populli i pafajshëm.

Situatat e njëpasnjëshme, të vendosura

në sup të njëra-tjetrën, i referohen ndodhive ngado vendit, sidomos gjatë viteve të



paharrueshme 1998 - 1999, në 18 muajt më dramatikë të historisë së Kosovës. Të tilla janë ngjarjet për familjarët e Lisit

dhe Erës, vdekja me akt të dhunshëm e babait të Lisit, vrasja e nënës mbi varrin e tij, djegia e shtëpisë... të tilla veprime, pra krime të ushtrisë serbe, ndodhin në çdo cep të Kosovës, ndaj autori nuk ka se si t'i shmangë personazhet e tij nga ajo llavë e dhunshme që kaploi tërë vendin që lufta e bëri shkruar e hi, ndërkohë që fushave e maleve iknin mijëra njerëz që Serbia i dëbonte nga vendbanimet, ku nuk kishte të ndalur plaçkitja dhe djegia e shtëpive, e gjësë së gjallë dhe gjithçkaje që kishin, ku njerëzit dhunoheshin e vriteshin para syve të më të dashurve, e të gjitha këto tmerre ishin të planifikuara si “procedura” poshtimi të papërshtatshëm me të cilin i detyronin për të lënë votrën e tokën e tyre. E vetmja gjë e mbetur te të shkretët njerëz ishte shpirti.

Pikërisht, me shpirtin plot ëndrra dhe dëshira, me të mbaruar lufta, Lisi vjen në Kosovë. Ai ka lënë aty gjithçka: fëmijërinë, prindërit, shtëpinë, e

mbi të gjitha dashurinë e jetës, Erën, me të cilën ndjehet i lidhur deri në përjetësi. Kthimi do ta përballë me më të paimagjinueshmen dhe më të padëshirueshmen. Tre varret e njerëzve më të dashur të jetës pllakosin në të ndjenja të forta dëshpërimi. Lotët dhe vaji i burrit kulmon mbi varrin e Erës me çjerrjen e faqeve dhe nxirjen e tyre me dhé. Ato janë e vetmja mënyrë për të nxjerrë jashtë mllëfini i cili e ka kapluar në këtë gjendje nga ku tashmë është i pafuqishëm të ndërrojë diçka.


Gjatë gjithë kohës në Amerikë ai ka jetuar me ankthin e përditshëm për fatin e Erës, prindërve dhe të tjerëve që përpëliteshin në zjarrin e luftës, gjë e cila u bë edhe më e vështirë kur linjat telefonike dolën jashtë funksionit. Tashmë që ka ardhur momenti i lirisë, në vend që të përqafohet me ëndrrimet e pafundme për lumturinë e jetës, djaloshi i duhet të kuptojë se ç'pasoja la mungesa e çdo ndjesie njerëzore e organeve të pushtetit gjakatar ndaj njerëzve të pambrojtur e të tmerruar. Gjuha autoriale sjell me një qartësi të hatashme rrëfimin rrëqethës për dramën tronditëse shpirtërore të personazhit.

Libri është shkruar mjeshtrosh. Në mes të rrëfimit që të çon zemrën peshë dhe, në momentin kur lexuesi kredhet në pellgun e trishtimit, autori përmes detajeve e nxjerr atë në breg të shpresës: shtëpia është djegur tërësisht por aty ka mbetur një shtyllë ku ai (Lisi) vuri fillimisht krahun e mandej mbështeti tërë trupin... Gjë që nënkupton se ajo ngrëhinë do të ringritet një ditë dhe do të mbushet patjetër me njerëz e me jetë.

Nuk është detaj por element i fuqishëm “ardhja” e Erës në përgjumjen e Lisit me veprime të realta, një simbolikë e fuqishme e komunikimit shpirtëror. Paralelizmi metafizik i ndërftuar disa herë nga autori, e bëjnë Erën të jetë sërish e gjallë dhe krah të dashurit të saj. Ajo nuk lejoi që dora dhunuese t'ia shëmtojë trupin dhe t'ia nxijë nderin, ndaj i ka të gjitha të drejtat morale të quhet Heroinë e dashurisë dhe Heroinë e Lirisë. Kjo e bën atë një protagoniste të fuqishme. Ndaj, rapodi do të ndërtojë vargje e do të këndojë krenueshëm si për një shqiptonjë të Dardanisë. Fustani i saj i nusërisë mbetet përjetësisht një ëndërr e bardhë, gjë të cilën ajo e paralajmëron në letrën e fundit: “...Besën time nuk do ta tresë dheu. Edhe nga bota tjetër do ta gjej mënyrën të të tregoj praninë time, dashurinë time që nuk fiket kurrë...” Forca e mbrojtjes së moralitetit nga ana e vajzës deri në vetëmohim rindërton legendën e re të besës së dhënë ku dashuria merr vlerë hyjnore.

Në shtjellimin e ngjarjeve dalin edhe personazhe të tjerë, si: familjarë, bashkëfshatarë, mësues, ushtarë dhe prijës të UÇK-së, secili nga ta të përballur në mënyra të ndryshme me demonin vrasës dhe traumat kolektive të një robërie të gjatë...

Migena Arllati



At' Shtjefën Gjeçovi meriton më shumë!

FRANK SHKRELI

Ish-Drejtor i VOA-s për Euro-Azinë


“Këto punë po i shkruaj këtu, o vëlla shqiptar, jo me ndonjë qëllim të keq, por pse po ma ka ënda me e mbështetë në to vjetërsinë e kombit tonë. Le ta marrë vesh bota se hyjnitë, mënyrat dhe sjelljet e besimtarëve, si grekët dhe latinët e vjetër, i patën prej etërve tanë, Pellazgëve”. (At Shtjefën Gjeçovi)

At Shtjefën Gjeçovi – klerik shqiptar françeskan, shkrimtar, publicist, përkthyes, etnograf dhe arkeologu i parë shqiptar. Më 1929, për shkak të veprimtarisë së tij patriotike, arsimore dhe kulturore u vra nga serbët në Kodrën Rrezin të Zymit të Hasit të Thatë. Viti 2024 do duhej të ishte shpallur vit kushtuar At Shtjefën Gjeçovit, me rastin e 150-vjetorit të vrasjes së tij nga armiqtë shekullorë të Kombit shqiptar. Ky propozim është bërë në një letër dërguar Ministrisë të Kulturës të Republikës së Kosovës, zotit Hajrullah Çeku, në fillim të këtij viti nga Kryetari i Akademisë dhe Arteve Republikës së Kosovës, Akademik Mehmet Kraja, sipas linkut të bashkangjitur: U mbajt konferenca shkencore ndërkombëtare “Krijimtaria e Shtjefën Gjeçovit (150-vjetori i lindjes)” – Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës (ashak.org)

Siç duket, propozimi i Kryetarit të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, paska renë në veshë të shurdhër të enteve të tjera të qeverisë e shtetit, por edhe të enteve të tjera të interesuara të Republikës së Kosovës, pasi nuk është venë re ndonjë veprimtari kushtuar vitit të Shtjefën Gjeçovit me rastin e 150-vjetorit të vrasjes së tij nga serbët. Tani shohim se paskan dalë bosh përpjekjet prej pothuaj prej një viti të Akademisë dhe Arteve të Kosovës, për të përfshirë ente dhe institucione të tjera shkencore dhe kulturore të Republikës së Kosovës, në organizimin e veprimtarive kushtuar At Shtjefën Gjeçovit në 150-vjetorin e vrasjes së tij nga serbët. Thuhet se entet që Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës shpresonte të bëheshin pjesë e këtij aktiviteti këtë vit, për të nderuar Shtjefën Gjeçovin, por që më në fund, duket se u tërhoqën, duke mos mbajtur premtimet, janë: Instituti Albanologjik, Instituti i Arkeologjisë, Universiteti i Prishtinës, Instituti i Historisë, Instituti i Trashëgimisë Kulturore, Komuna e Prishtinës, Komuna e Lipjanit etj. Por në radhë të parë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit duhej të ishte, sipas ekspertëve, enti kryesor bashkrendues përgjegjës. Sidoqoftë, siç duket, i vetmi aktivitet kushtuar 150-vjetorit të Shtjefën Gjeçovit nga serbët, u zhvillua me 14 tetor 2024, një organizim ky – në minutën e fundit – nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës dhe Akademia e Shkencave të Shqipërisë. Me një organizim që të sjell në mend atë frazën popullore: “Më ka çu baba sa me la gojën”, u mbajt konferenca shkencore e quajtur “ndërkombëtare”, me titull: “Krijimtaria e Shtjefën Gjeçovit. Por, pa mbështetjen zyrtare të enteve të lartpërmendura, ndërsa pjesëmarrja, sipas fotografive, dukej shumë e pakët,

madje sipas disa burimeve, një numër folësish që kishin premtuar të merrnin pjesë, emrat e të cilëve ishin në program, as nuk kishin ardhur.

Është e vështirë të merret me mend se në interes të kujt është që vepra dhe jeta e At Shtjefën Gjeçovit të “mbetet në heshtje për



një kohë të gjatë” siç u shpreh edhe Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Mehmet Kraja në fjalën e tij të mbajtur në konferencën shkencore me 14 tetor në Prishtinë. Nisma e Akademisë në fillim të këtij viti, për ta sjellë veprën dhe sakrificën e Gjeçovit në vëmendje të publikut në Kosovë, por edhe në Shqipëri, në 150-vjetorin e lindjes së tij nuk gjeti mbështetjen e nevojshme tek institucionet shkencore, kulturore dhe arsimore të Kosovës, as të Shqipërisë. “Nuk e mbajtën fjalën të gjithë ata që na premtuan se do të bëheshin pjesë e kësaj devotshmërie dhe respekti për Gjeçovin dhe veprën e tij. Në mungesë të kësaj mbështetje, ne patëm vetëm një zgjidhje: përmes kësaj konference, t’i japim zë shkencor punës së vyer të Shtjefën Gjeçovit, duke hedhur dritë mbi aspekte të ndryshme të jetës dhe veprës së tij”, është shprehur Akademiku Mehmet Kraja në fjalën e tij në konferencën shkencore. Lexoni fjalën e plotë me këtë rast të Kryetarit të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Z. Mehmet Krajës, marrë nga portali i tij (facebook):

Akademiku Mehmet Kraja, Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, duke mbajtur fjalën e rastit në konferencën që siç duket — në mungesë të mbështetjes nga entet e tjera, u organizua shpejt e shpejt, në minutën e fundit. Kjo shihet nga mungesa e të pranishëmve në sallë madje edhe e disa ligjëruesve (24 gjithsej) emrat e të cilëve ishin në programin e konferencës për të folur, por siç duket nuk ishin prezent.

“Dua të them që në fillim se ne e zgjodhëm 14 tetorin për këtë konferencë kushtuar Gjeçovit (pra dita e vrasjes së tij), për të kujtuar me pietet jo vetëm kontributin e tij për dijen dhe kulturën tonë, si themelues i arkeologjisë shqiptare, ndër të tjera, por më shumë për të sjellë në vëmendje se

historia mund t’u përsëritet atyre që nuk dinë të nxjerrin mësimet e vjera prej saj. Pra, duke vlerësuar lart figurën e Gjeçovit në këtë 150-vjetor të lindjes së tij, deshëm që ky vit në Kosovë të quhej vit i Gjeçovit, sa në shenjë respekti për veprën dhe kontributin e tij, po aq edhe për faktin se gjatë

rënien e socializmit dhe po ashtu nuk duhet të habitemi që një numër veprash në dorëshkrim të Gjeçovit, si drama, novela dhe përkthime nuk e panë ndonjëherë dritën e botimit.

Si përfundim, dua të theksoj këtu se Gjeçovi është rilindës, rilindësi më i rëndësishëm i Kosovës, me të gjitha atributet që i kanë burrat me mendjen më të ndritur të kombit shqiptar. Ai ishte i pari rilindës që zbuloi se jo vetëm idetë dhe fryma jolëndore mund të flasin shqip, por shqip mund të flasë edhe toka, edhe një terakotë, edhe një kabanë e lënë në harresë. Ai po ashtu zbuloi se mund të jetë monument kulturor me vlerë të paçmuar edhe e drejta zakonore e kodifikuar, padrejtësisht e apostrofuar nga ideologjitë si pengesë e prosperitetit tonë kombëtar”. (Dr Mehmet Kraja – ishte kjo fjala e tij në konferencën me rastin e 150-vjetorit të Shtjefën Gjeçovit, mbajtur në Prishtinë disa ditë më parë).

Unë e kam të vështirë ta marr me mend se kush janë personat, organizatat dhe entet zyrtare të shqiptarëve, qofshin ato edhe qeveritare, që vërtetë duan të hedhin në harresë veprën dhe kontributin e At Shtjefën Gjeçovit. Për më tepër pyes veten se pse? Besoj se në fjalën e tij, Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Dr. Mehmet Kraja hedh dritë mbi disa prej arsyeve se pse At Shtjefën Gjeçovi nuk gëzon mbështetje asnjohjen e duhur, zyrtare, për veprimtarinë e tij – as në Kosovë e as në Shqipëri. I madhi Faik Konica ka thenë se: “Po, At Gjeçovi është përmi çdo sharje. Emri i këtij njeriu të rrallë do të vejë duke urritur...” – Duket se edhe Konica paska qenë i gabuar në parashikimet e tija se emri i Shtjefën Gjeçovit, “do vejë duke urritur”, ndër shqiptarë. Përkundrazi, kam drojë se duke gjykuar punët nga ky organizim i cunguar për të nderuar jetën dhe veprimtarinë e Gjeçovit në 150-vjetorin e tij – jo vetëm që emri i Gjeçovit nuk po rritet ndër shqiptarët, por ai gradualisht, po hidhet në harresë, zyrtarisht, si shumë të tjerë, përfshirë At Gjergj Fishtën – në përputhje të plotë me trashëgiminë sllavo-komuniste — që për fat të keq të Kombit — ende mbizotëron në (mos)trajtimin zyrtar të këtyre figurave të mëdha kombëtare, në korridoret vendimarrëse të Prishtinës dhe Tiranës zyrtare. Vlerësimet më të mëdha, me këtë rast, për Akademikun Mehmet Kraja dhe për ata kolegë të tij që u përpoqën ta shënojnë në mënyrë të dinjitetshme 150-vjetorin e At Shtjefën Gjeçovit! Turp për të gjithë ata — në të dy anët e kufirit shqiptaro-shqiptar që për 35 vite tani, vazhdojnë t’i trajtojnë këto figura kombëtare, si At Shtjefën Gjeçovi, në frymën më të shëmtuar të nostalgjisë ndaj regjimeve sllavo-komuniste në trojet shqiptare. Siç tha në fjalën e tij edhe Dr Mehmet Kraja, përkujtime të tilla, siç është 150-vjetori i Gjeçovit, në mos për asgjë tjetër, atëherë duhet të shënohen, “më shumë për të sjellë në vëmendje se historia mund t’u përsëritet atyre që nuk dinë të nxjerrin mësimet e vjera prej saj.” Prandaj, Shtjefën Gjeçovi meriton më shumë se kaq!

Pikturat e Gjelosh Mitaj, melodi e shpirtit artistik

Galeria e Arteve Shkodër sot, me 5 tetor 2024, buzëqeshi dhe meditoj me nota lirike dhe epike

Miku ynë i nderuar piktori Gjelosh Mitaj kishte hapur Ekspozitën e tij, me punime të përzgjedhura

Pikturat e tij janë një kolazh frymëzimi artistik i qëndisur në telajo. Piktura është një gjini artistike, që ju buzëqesh vetëm atyre që dinë ta lexojnë.

Gjelosh Mitaj është një piktor i lindur aty ku toka uthet me qiellin dhe hëna fletë tek mrizi i zanave, aty ku bleta ngatër-

ron lulet me vajzat, ku ujëvarat dalin nga shkëmbi dhe normalisht frymëzimi është pjesë e pjesë e genit të tij.

Miku im i nderuar piktori Kelmendasi Gjelosh Mitaj, është një talent që sjell në art të bukurën. Portreti, peizazhi epik dhe ai lirik janë dashuria e penelit të tij. Në gjurmët e piktorëve, që ai adhuron, Sadik Kaceli dhe Smajl Lulani mjeshtër i ngjyrave të forta dhe imazhit ngacmues.

Ai është një talent i lindur dhe një krijues për Shkodrën dhe Malësinë, ekspozita e tij ishte si një Ylber ngjyrash në tetor.

Shumë miq të tij ishin sot në orët e para të hapjes të Ekspozitës, e cila qëndroi e hapur disa dite. Arti i piktorës nuk është kafe, që pihet dhe shijohet nga të gjithë, prandaj edhe vizitorët ishin të zgjedhur.

Ju miku im i nderuar z. Gjelosh Mitaj jeni një pasuri dhe vlerë e këtij qyteti.

Respekt për punën tuaj! Suksese dhe frymëzim për të tjera vepra arti!

Bashkia Shkodër dhe ajo Malësi e Madhe kane mbështetur, suportuar dhe vlerësuar shumë koleg në fusha të ndryshme të artit, por nëse e vizitojnë këtë Ekspozite do të binden se këtij piktori duhet ti jepet ajo që meriton "Mirënjohje dhe vlerësimi institucional"!



REDAKSIA

Kryeredaktore: Klodjana Serraj
Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri,
Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia Dushi, Leke Sokoli,
Edmond Tërthorja, Lulash Brigja, Vilson Peshkaj, Prele Shytani,
Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi botimin
PREKË KULLA

